



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

*Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit
Ministarstvo obrazovanja, nauke, tehnologije i inovacije
Ministry of Education, Science, Technology and Innovation*

► Modul Trajnimi për Drejtoritë Komunale të Arsimit

Roli i Drejtorive Komunale të Arsimit për të mbështetur shkollat në sigurimin e cilësisë, mbrojtje të fëmijës dhe eliminimin e pengesave të qasjes në arsim

► **Modul Trajnimi për Drejtoritë Komunale të Arsimit**

Roli i Drejtorive Komunale të Arsimit për të mbështetur shkollat në sigurimin e cilësisë, mbrojtje të fëmijës dhe eliminimin e pengesave të qasjes në arsim

Modul trajnimi për Drejtoritë Komunale të Arsimit (DKA):

Roli i Drejtorive Komunale të Arsimit për të mbështetur shkollat në sigurimin e cilësisë, mbrojtje të fëmijës dhe eliminimin e pengesave të qasjes në arsim

Autorë:

Selim Mehmeti

Informacion

Ky modul trajnimi për Drejtoritë Komunale të Arsimit është përgatitur që të shërbej si material trajnimi për Koordinatorët e cilësisë në DKA dhe EPRBM në nivel komune, me qëllim ngritjen e kapacitetit të tyre lidhur me përmbushjen e rolit të tyre për të mbështetur shkollat në sigurimin e cilësisë, identifikimin dhe eliminimin e pengesave në arsim, mbrojtje të fëmijës, parandalim të dhunës, braktisjes dhe mosregjistrimit të shkollës.

Temat bazë të këtij moduli që lidhen me problemin e punës së fëmijës, mbrojtjen e fëmijës dhe sigurimin e cilësisë në arsimin parauniversitar, të trajtuara nga perspektiva e rolit të Drejtorive Komunale të Arsimit, i referohen modulit të trajnimit të përgatitur për Inspektorë të Arsimit, të hartuar po ashtu me mbështetje nga ILO.

Moduli i trajnimit në të ardhmen mund të përdoret nga Njësia për të Drejtat të Njeriut në MASH dhe Koordinatori i Cilësisë në MASHTI për organizimin e trajnimeve të tjera me DKA për këtë temë. Gjithsesi, moduli mund të shërbej Drejtorive Komunale të Arsimit për informata shtesë në punën e tyre.

Mirënjohje dhe falënderim të veçantë për Lindita Boshtrakaj nga ILO dhe Merita Bajraktari-Jonuzi nga MASHTI, që dhanë kontribut të çmuar në të gjitha fazat e përgatitjes së këtij materiali. Gjithashtu, falënderojmë Osman Beka, ushtrues detyre i koordinitorit të cilësisë në MASHTI dhe të gjitha DKA për bashkëpunimin në organizimin e trajnimit me koordinatore të cilësisë dhe EPRBM komunale.

► FALËNDERIME

Kjo iniciativë është pjesë e projektit projektit “Masat, ndërgjegjësimi dhe përfshirja e politikave në përsheptimin e veprimeve kundër punës së fëmijëve dhe punës së detyruar (MAP 16)” në mbështetje të Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZHQ) Caku 8.7. Fondet janë mundësuar nga Departamenti i Punës i SHBA-së në kuadër të marrëveshjes së bashkëpunimit me numër IL 30147 16 75 K 11. 100% e të gjitha shpenzimeve të projektit financohen nga fondet federale, në vlerë prej 22,4 million dollarësh, prej të cilave \$162,000 janë alokuar për aktivitetet në Kosovë.

► NJOFTIM:


Ky material nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet ose politikat e Departamentit të Punës të Shteteve të Bashkuara, dhe as përmendja e emrave tregtarë, produkteve komerciale ose organizatave nuk nënkupton miratimin nga Qeveria e Shteteve të Bashkuara.

▶ Përmbajtja


▶ Shkurtesat	8
▶ Pjesa I: Hyrje	9
1.1. Konteksti i përgatitjes së modulit të trajnimit për Drejtoritë Komunale të Arsimit	10
1.2. Nevojat për këtë modul trajnimi për Drejtoritë Komunale të Arsimit	11
1.3. Qëllimi i modulit të trajnimit	12
1.4. Çfarë përmban moduli i trajnimit për Drejtoritë Komunale të Arsimit?	13
▶ Pjesa II: Punëtorja me Inspektorë të Arsimit	15
2.1. Agjenda e punëtorisë	16
Tema 1: Problemi i punës së fëmijëve: ndërlidhja me braktisjen e shkollës dhe cilësinë e arsimit	18
Tema 2: Korniza e politikave arsimore për mbrojtjen e fëmijëve në Kosovë	19
Tema 3: Kuadri ligjor dhe pakoja e dokumenteve për sigurimin e cilësisë në arsimin parauniversitar që lidhen me rolin e DKA	20
Tema 4: Roli i DKA në krijimin e kushteve për vijueshmëri, qasje të fëmijëve/nxënësve në mësim dhe mbrojtje të fëmijës	21
Tema 5: Monitorimi dhe vlerësimi, mbështetja dhe raportimi për EPRBM	22
▶ Pjesa III: Materiale plotësuese dhe udhëzime	25
3.1. Problemi i punës së fëmijëve: ndërlidhja me braktisjen e shkollës dhe cilësinë e arsimit	26
3.2. Korniza e politikave arsimore për mbrojtjen e fëmijëve në Kosovë	28
3.3. Kuadri ligjor dhe pakoja e dokumenteve për sigurimin e cilësisë në arsimin parauniversitar që lidhen me rolin e DKA	32
3.4. Roli i DKA në krijimin e kushteve për vijueshmëri, qasje të fëmijëve/nxënësve në mësim dhe mbrojtje të fëmijës	38
3.5. Monitorimi dhe vlerësimi, mbështetja dhe raportimi për EPRBM	44
▶ Pjesa IV: Shtojca	49
Shtojca 1: Roli i institucioneve arsimore në adresimin e punës së fëmijëve - Përmbledhje e raportit për obligimet e institucioneve arsimore për zbatimin e Udhëzimit Administrativ QRK 05/2013 parandalimin dhe ndalimin e formave rrezikshme të punës së fëmijëve në Kosovë	50
Shtojca 2: Pjesë nga raporti përmbledhës mbi gjetjet nga monitorimi dhe mentorimi i DKA-ve dhe shkollave, lidhur me funksionimin e EPRBMSH	52
Shtojca 3: Korniza e kriterëve të cilësisë së performancës së shkollës	55
Shtojca 4: Listë kontrolli për dëshmitë e shkollës lidhur me masat për Parandalim dhe reagim kundër braktisjes dhe mosregjistrimit	56
Shtojca 5: Formulari me listën e pyetjeve sipas indikatorëve për parandalim dhe reagim ndaj braktisjes dhe mosregjistrimit të shkollës	58
Shtojca 6: Referencat që janë përdorur për zhvillimin e modulit	60

▶ Shkurtesat

- ▶ BE Bashkimi Evropian
- ▶ DKA Drejtoria Komunale e Arsimit
- ▶ DUDNJ Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut
- ▶ ECMI Qendra Evropiane për Çështje të Minoriteteve
- ▶ EPRBM Ekipi për Parandalim dhe Reagim ndaj Braktisjes dhe Mosregjistrimit
- ▶ GIZ Korporata Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar
- ▶ IA Inspektorati i Arsimit
- ▶ ILO Organizata Ndërkombëtare e Punës
- ▶ IPK Instituti Pedagogjik i Kosovës
- ▶ KDF Konventa e të Drejtave të Fëmijëve
- ▶ KEC Qendra për Arsim e Kosovës
- ▶ KN Këshilli i Nxënësve
- ▶ KSC Koordinator për Sigurim të Cilësisë
- ▶ MASHTI Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit
- ▶ OECD Organizata për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim
- ▶ OJQ Organizata Joqeveritare
- ▶ PPRBM Platforma për parandalim dhe reagim ndaj braktisjes dhe mosregjistrimit
- ▶ PSAK Plani Strategjik i Arsimit në Kosovë
- ▶ QMF Qendra për Mjekësi Familjare
- ▶ QPS Qendra për Punë Sociale
- ▶ SIA Sektori i Inspektoratit të Arsimit
- ▶ SMIA Sistemi i Menaxhimit të Informatave në Arsim
- ▶ SPH Sistemi i Paralajmërimit të Hershëm
- ▶ UA Udhëzim Administrativ
- ▶ UNICEF Fondi i Kombeve të Bashkuara për Fëmijë
- ▶ VJPSH Vlerësimi i jashtëm i performancës së shkollës



Hyrje



1.1. Konteksti i përgatitjes së modulit të trajnimit për Drejtoritë Komunale të Arsimit

Gjatë dekadës së fundit të arsimit në Kosovë është rritur përqendrimi i institucioneve arsimore në krijimin e kushteve dhe mundësive të barabarta në arsim për të gjithë. Kësaj i ka paraprirë Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI) përmes zhvillimit të politikave arsimore dhe krijimit të mekanizmave përkatës, duke u bazuar në përgjegjësitë kryesore që ka për të promovuar sistem të arsimit jo diskriminues, sigurinë dhe mirëqenien e secilit nxënës, mbrojtje të grupeve të ndjeshme në kuadër të sistemit të arsimit dhe aftësimin, si dhe për të avancuar masat për mbrojtje të fëmijës. Për këtë të fundit, për të avancuar masat për mbrojtje të fëmijës, përfshirë masat për parandalimin e braktisjes dhe mosregjistrimit të shkollës, MASHTI ka zhvilluar politika arsimore që përcaktojnë rolet dhe përgjegjësitë e institucioneve arsimore në nivel qendror, komunal dhe në nivel shkolle, mënyrën e punës për adresimin e rasteve të braktisjes dhe mos-regjistrimit të shkollës. Në linjë me këtë, MASHTI ka realizuar disa masa që mbështesin zbatimin e politikave në këtë fushë, si:

- Zhvillimin e politikave për parandalim dhe referim të dhunës në shkolla;
- Hartimin e manualeve didaktike për parandalim të dhunës dhe dukurive negative në shkolla;
- Përshtatjet dhe validimin e materialeve didaktike të Organizatës ndërkombëtare të punës që lidhen me parandalimin e përfshirjes së fëmijëve në punë të rrezikshme;
- Mbështetjen e institucioneve arsimore në themelimin e Ekipeve për parandalim dhe reagim ndaj braktisjes dhe Mosregjistrimit në arsimin parauniversitar (EPRBM), nga niveli qendror deri në nivel shkolle;
- Hartimi i doracakëve për shkollat dhe komunat në mbështetje të EPRBM;
- Zhvillimin e Modulit për Sistemin e Paralajmërimit të Hershëm (SPH) të braktisjes në SMIA;
- Përfshirjen e masave e aktiviteteve të veçanta për parandalimin e braktisjes së shkollës, në

Planet strategjike për MASHTI që lidhen me arsimin parauniversitar (si në PSAK, Strategjinë për integrimin e komuniteteve romë, ashkali dhe egjiptianë në Kosovë, Strategjinë për riintegrimin e personave të riatdhesuar, etj.).

- Realizimin e projekteve me përkrahje nga partnerët që mbështesin arsimin në Kosovë, si UNICEF, ECMI, KEC, GIZ, për parandalimin dhe reagim ndaj braktisjes së shkollës, etj;
- Plani e veprimit për vitin 2021 me objektiva/caqe, masa/aktivitete dhe tregues përkatës për parandalimin e braktisjes dhe mosregjistrimit të shkollës;
- Organizimin tradicional të javës kundër braktisjes, me moton **“Mundësi të barabarta në arsim për të gjithë”**; Etj.

Në anën tjetër, mbi bazën e dokumentit *Strategjia e Sigurimit të Cilësisë për Arsimin Parauniversitar në Kosovë 2016-2020*, MASHTI ka zhvilluar dokumentet për sigurim të cilësisë, ka përcaktuar pritshmëritë themelore për çdo shkollë në Republikën e Kosovës dhe ka vendosur sistemin e vlerësimit të performancës së shkollës. Zbatimi i këtyre politikave arsimore lidhet ngushtë me rolin dhe përgjegjësitë e MASHTI, Komunave/DKA, Inspektoratit të Arsimit dhe institucioneve arsimor/shkollave.

Masat për mbrojtjen e fëmijëve, parandalimin e dhunës si dhe për parandalim dhe reagim ndaj braktisjes dhe mosregjistrimit (bashkë me funksionimin e mekanizimit të EPRBM), janë të integruara edhe në politikat arsimore që lidhen me sigurimin e cilësisë në arsimin parauniversitar në Kosovë.

Duhet veçuar argumentin se me vendosjen e mekanizimit të EPRBM në nivel qendror, në nivel komune dhe shkolle, është bërë progres në punën e tyre dhe njëkohësisht janë identifikuar sfida dhe nevoja që duhet të adresohen përmes një procesi të monitorimit institucional për zbatimin e platformës për Parandalim dhe Reagim kundër Braktisjes dhe Mosregjistrimit (PRBM). Përmes funksionimit të mirë të EPRBM mund të shihet perspektiva e përgjithshme e mbrojtjes së fëmijëve në kontekst të shkollës, ngase barrierat për vijueshmëri, qasje të fëmijëve/nxënësve në mësim janë të dimensioneve të ndryshme.

Për adresimin e sfidave dhe nevojave të dala gjatë procesit të zbatimit të masave për parandalim dhe reagim ndaj braktisjes dhe mosregjistrimit,

EPRBM në nivel qendror ka hartuar planin dinamik të punës kundër braktisjes dhe mosregjistrimit të shkollës për vitin 2021. Objektiva nr. 1 e këtij plani i referohet **Fuqizimit të mekanizmave për monitorim, mentorim dhe mbikëqyrje të zbatimit të platformës për parandalim dhe reagim ndaj braktisjes**. Në kuadër të këtij objekti, krahas punëtorive me Inspektorët e arsimit, janë planifikuar edhe punëtori e sesione trajnimi me DKA. Me qëllim që punëtoritë dhe sesionet e trajnimit me DKA të adresojnë nevojat e organizimit të punës së tyre në këtë fushë, është iniciuar ky modul i trajnimit, i cili është përgatitur me mbështetje nga Projekti i ILO-së MAP '16¹.

Moduli i trajnimit dhe punëtorja me DKA është përgatitur në konsultim të ngushtë me Njësinë për të Drejta të Njeriut në MASHTI dhe Koordinatorin e Cilësisë në MASHTI. Përgatitja e modulit të trajnimit përfshiu një analizë të politikave, dokumenteve e udhëzuesve që lidhen me (i) *punën e fëmijëve dhe definojnë rolin e institucioneve arsimore në parandalimin dhe eliminimin e punës së fëmijëve*; (ii) *mbrojtjen e fëmijës, parandalimin e dhunës në institucione arsimore parauniversitare, masat për parandalim dhe reagim ndaj braktisjes dhe mosregjistrimit*; (iii) *sigurim të cilësisë në arsimin parauniversitar*; (iv) *rolin e DKA në menaxhimin e arsimit në nivel komune dhe në mbështetjen e shkollave në përmbushjen e pritshmërive të tyre*, etj.

Mbi këtë bazë, fillimisht është zhvilluar koncepti i modulit të trajnimit, agjenda e punëtorisë njëditore me DKA, pastaj në modulën e trajnimit janë reflektuar përmbajtjet sipas temave të përcaktuara.

Duke besuar se ky modul i trajnimit dhe punëtorja njëditore me DKA, i plotësojnë nevojat e koordinatorëve të cilësisë në DKA dhe EPRBM në nivel komunal, ne i inkurajojmë koordinatorët e cilësisë në DKA dhe EPRBM që të marrin këtë modul të trajnimit, dokumentet që lidhen me sigurimin e cilësisë së punës së shkollës, dokumentet që lidhen me mbrojtjen e fëmijës dhe me punën e EPRBM, dhe në frymën e praktikave të mira të fillojnë aktivisht dhe në koordinim të plotë në mes vete përmbushjen e rolit të tyre

në sigurimin e cilësisë, mbrojtje të fëmijës dhe eliminimin e pengesave të qasjes në arsim, si dhe në mbështetjen e shkollave në nivel të komunës në këto fusha.

1.2. Nevoja për një modul të trajnimit për DKA në sigurimin e cilësisë, mbrojtje të fëmijës dhe eliminimin e pengesave të qasjes në arsim

Si rezultat i proceseve të zhvilluara lidhur me sigurimin e cilësisë në institucionet arsimore parauniversitare dhe punën e koordinatorëve të cilësisë në nivel komune dhe shkolle, punën e EPRBM dhe Sistemin e Paralajmërimit të Hershëm të braktisjes - brenda Sistemit të Menaxhimit të Informatave në Arsim, janë shtuar nevojat për monitorim, mentorim dhe mbikëqyrje në mënyrë institucionale dhe të vazhdueshme të shkollave dhe EPRBM-ve lidhur me qasjet ndaj mbrojtjes së fëmijës dhe eliminimin e pengesave të qasjes në arsim. Tani kemi në fuqi edhe Ligjin për mbrojtjen e fëmijëve që na obligon për veprimet tona institucionale në adresimin e çdo barriere që e sfidon zhvillimin e fëmijëve në aspekt fizik, intelektual, social e emocional.

Duke marrë parasysh rolin dhe përgjegjësitë që kanë DKA, si një mekanizëm qendror i nivelit lokal në ofrimin e arsimit parashkollor, fillor dhe të mesëm, menaxhimin me personelin mësimdhënës dhe jo mësimdhënës, menaxhimin e administrimit të institucioneve arsimore parauniversitare në nivel komune dhe trajnimit e mësimdhënësve e administratorëve të arsimit, si dhe në koordinimin e punës me MASHTI, Shkollat dhe Inspektoratin e Arsimit për sigurimin e cilësisë, mbrojtje të fëmijës dhe eliminimin e pengesave të qasjes në arsim, ka lindur nevoja për zhvillimin e këtij moduli të trajnimit për DKA, me theks të veçantë për koordinatorët e cilësisë në DKA dhe EPRBM-të në nivel komunal.

¹ Masat, ndërgjegjësimi dhe përfshirja e politikave në përsheptimin e veprimeve kundër punës së fëmijëve dhe punës së detyruar (MAP 16)" i cili financohet nga Departamenti i Punës i SHBA-së dhe menaxhohet nga Organizata Ndërkombëtare e Punës. Prioritetet e projektit MAP '16 në Kosovë:

- Fuqizimi i kornizës qendrore dhe ligjore dhe institucionale për mbikëqyrjen e situatës së punës së fëmijëve dhe planifikimin e bazuar në fakte të masave për adresimin e punës së fëmijëve;
- Fuqizimi i rolit të sistemit të mbrojtjes sociale në mbrojtjen e fëmijëve nga puna;
- Fuqizimi i rolit të sistemit arsimor në parandalimin e punës së fëmijëve dhe mbrojtjen e fëmijëve nga puna;
- Përmirësimi i zbatimit të legjislationit dhe politikave për mbrojtjen e fëmijëve nga puna.

1.3. Qëllimi i programit të trajnimit

Qëllimi i programit të trajnimit është rritja e kapacitetit të DKA-ve në realizimin e praktikave efikase për mbështetje të shkollave në mbrojtje të fëmijës, parandalim të dhunës, braktisjes dhe mosregjistrimit të shkollës. Programi i trajnimit dhe punëtorja me DKA-të ka për qëllim mbështetjen e Koordinatorëve të cilësisë dhe EPRBM në nivel komunal për të:

- ▶ kuptuar ndërlidhjen e problemit të punës së fëmijëve me braktisjen e shkollës dhe cilësinë e arsimit;
- ▶ eksploruar kuadrin e politikave arsimore për mbrojtjen e fëmijëve në Kosovë dhe sigurim të cilësisë, në ndërlidhje me rolin e DKA;
- ▶ zhvilluar idetë dhe orientimet për përmbushjen e rolit të DKA në krijimin e kushteve për vijueshmëri, qasje të fëmijëve/nxënësve në mësim dhe mbrojtje të fëmijës;
- ▶ udhëzuar dhe mbështetur KC dhe EPRBM në realizimin e praktikave të mbështetjes së shkollave në mbrojtje të fëmijës, parandalim të dhunës, braktisjes dhe mosregjistrimit; si dhe për
- ▶ nxitur angazhimin e vazhdueshëm të KC dhe EPRBM në mbështetjen e shkollave dhe në përmbushjen e rolit të tyre në sigurimin e cilësisë, mbrojtje të fëmijës dhe eliminimin e pengesave të qasjes në arsim.

Mekanizmat në nivel komune, si KSC dhe EPRBM, janë mekanizma që vendosen dhe themelohen nga autoritetet komunale, përkatësisht DKA- të dhe funksionojnë sipas procedurave të përcaktuara me udhëzimet administrative përkatëse të hartuara nga MASHTI. Kjo nënkupton se funksionimi i tyre dhe zbatimi i politikave e masave për mbrojtjen e fëmijës, parandalimin e dhunës, parandalim dhe reagim ndaj braktisjes dhe mosregjistrimit, sigurim të cilësisë në arsimin parauniversitar, etj., i nënshtrohen roleve, përgjegjësisë, qasjeve dhe procedurave të punës që organizohen nga autoritetet komunale, Drejtoritë Komunale të Arsimit, në bazë të standardeve dhe kritereve të përcaktuara nga MASHTI. Prandaj,

▶ Ky modul i trajnimit është hartuar me qëllim që kontribuoj dhe përkrah në:

Ngritjen e kapacitetit të DKA-ve në realizimin e praktikave efikase për mbështetje të shkollave në mbrojtje të fëmijës, parandalim të dhunës, braktisjes dhe mosregjistrimit të shkollës;

Koordinimin e veprimeve ndërinstucionale në zbatim të detyrimeve ligjore për mbrojtje të fëmijës, parandalimin e dhunës në institucione arsimore, parandalimin e dhunës në institucione arsimore, parandalimin dhe reagimin ndaj braktisjes dhe mosregjistrimit të shkollës;

Vendosjen e një agjende dhe plani të punës nga Drejtoritë Komunale të Arsimit për të përmbushur rolin e tyre në sigurimin e cilësisë, mbrojtje të fëmijës dhe eliminimin e pengesave të qasjes në arsim;

1.4 Çfarë përmban moduli i trajnimit për Drejtoritë Komunale të Arsimit (DKA)

Modul trajnimi për Drejtoritë Komunale të Arsimit (DKA): *Roli i Drejtorive Komunale të Arsimit për të mbështetur shkollat në sigurimin e cilësisë, mbrojtje të fëmijës dhe eliminimin e pengesave të qasjes në arsim*, është strukturuar në formatin e një udhëzuesi për realizimin e një punëtorie njëditore me Koordinatorët e cilësisë në DKA dhe udhëheqësit e EPRBM-ve në nivel komune. E gjithë përmbajtja e modulit është strukturuar në pesë tema kryesore dhe nëntemat të lidhura me to, të cilat janë të ndërlidhura në mes vete, referuar qëllimit të modulit dhe përdorimit të tij.

Temat janë përqendruar në konceptet kryesore, parimet, proceset dhe strategjitë për sigurim të cilësisë, adresimin e problemit të punës së fëmijëve, mbrojtje të fëmijëve, parandalim dhe reagim ndaj braktisjes dhe mosregjistrimit. Temat e modulit të trajnimit janë shoqëruar me burime për informata shtesë, si dhe me udhëzime praktike për aspektet që lidhen me zbatimin e vlerësimit të performancës së shkollës dhe me mbikëqyrjen e zbatimit të platformës për parandalim dhe reagim ndaj braktisjes dhe mosregjistrimit.

Temat kryesore që trajtohen në këtë modul janë si në vijim:

- Problemi i punës së fëmijëve: ndërlidhja me braktisjen e shkollës dhe cilësinë e arsimit
- Korniza e politikave arsimore për mbrojtjen e fëmijëve në Kosovë
- Kuadri ligjor dhe pakoja e dokumenteve për sigurimin e cilësisë në arsimin parauniversitar që lidhen me rolin e DKA
- Roli i DKA në krijimin e kushteve për vijueshmëri, qasje të fëmijëve/nxënësve në mësim dhe mbrojtje të fëmijës
- Monitorimi dhe vlerësimi, mbështetja dhe raportimi për EPRBM

Përdorues të drejtpërdrejtë të këtij moduli të trajnimit do të jenë koordinatorët e cilësisë në DKA dhe EPRBM në nivel komunal. Moduli i trajnimit në të ardhmen mund të përdoret nga Njësia për të Drejta të Njeriut në MASHTI dhe Koordinatori i Cilësisë në MASHTI për organizimin e trajnimeve

të tjera me DKA për këtë temë. Gjithsesi, moduli mund tu shërbej Drejtorive Komunale të Arsimit për informata shtesë në punën e tyre.

Referimi rreth angazhimeve institucionale për parandalim të dhunës në shkollë, parandalim të braktisjes dhe mosregjistrimit të fëmijëve/nxënësve në shkollë do ti shërbej fillimit të ndërtimit të bashkëpunimit dhe partneritetit institucional në mbrojtje të fëmijës, në mënyrë të veçantë në adresimin e problemit të braktisjes së shkollës.

▶ 2


Punëtorja me Drejtoritë Komunale të Arsimit

Agjenda e punëtorisë - Temat dhe çështjet kryesore sipas temave

Temat dhe çështjet kryesore sipas temave

Rezultatet e pritura për sesione dhe tema

Metodologjia dhe burimet



2.1 Agjenda e Punëtorisë

Koha	Temat
9:00-9:15	Mirëseardhje dhe hapja e punëtorisë Njoftimi me prioritetet e projektit MAP '16 në Kosovë – Objektivi: <i>Fuqizimi i sistemit arsimor për reagim adekuat ndaj punës së fëmijëve.</i>
9:15-9:30	Prezantimi i pjesëmarrësve
9:30-10:30	<p>Problemi i punës së fëmijëve: ndërlidhja me braktisjen e shkollës dhe cilësinë e arsimit</p> <ul style="list-style-type: none"> ► Problemi i punës së fëmijëve: Si ndikon puna e fëmijëve dhe cilësia e arsimit në braktisjen e shkollës nga fëmijët? ► Format më të këqija dhe të rrezikshme të punës së fëmijëve ► Barrierat e qasjes në arsim ► Sistemi i mbrojtjes së fëmijëve: Si mund t'i kontribuoj këtij sistemi DKA, EPRBM në nivel komunal? <p>Korniza e politikave arsimore për mbrojtjen e fëmijëve në Kosovë</p> <ul style="list-style-type: none"> ► Planet strategjike; ► Protokollin për parandalimin dhe referimin e dhunës në institucionet e arsimit parauniversitar ► Udhëzimi Administrativ për EPRBM & Doracakët për EPRBM; ► Moduli për Sistemin e Paralajmërimit të Hershëm (SPH) të braktisjes në SMIA; ► UA për mbrojtjen e fëmijëve në internet ► Pakoja e udhëzuesve për mbrojtjen e fëmijëve në internet
10:30-11:00	Pauza
11:00-12:00	<p>Kuadri ligjor dhe pakoja e dokumenteve për sigurimin e cilësisë në arsimin parauniversitar që lidhen me rolin e DKA</p> <ul style="list-style-type: none"> ► Aspektet kryesore që lidhen me sistemin e sigurimit të cilësisë në arsimin parauniversitar; ► Legjislacioni bazë dhe dokumentet për sigurimin e cilësisë; ► Mekanizmat për sigurim të cilësisë; <p>Roli i DKA-së në sigurimin e cilësisë</p> <ul style="list-style-type: none"> ► Funksionalizimi i KSC në nivel shkolle ► Vlerësimi i performancës së shkollës ► Proceset e planifikimit zhvillimor të institucioneve arsimore ► Mbështetja e shkollave në sigurimin e cilësisë
12:00-13:00	Dreka

Koha	Temat
13:00-14:00	<p>Roli i DKA në krijimin e kushteve për vijueshmëri, qasje të fëmijëve/nxënësve në mësim dhe mbrojtje të fëmijës</p> <ul style="list-style-type: none"> ▶ Roli i EPRBM komunale në parandalimin, reagimin dhe trajtimin adekuat të problemit të braktisjes dhe mos-regjistrimit në arsimin e obliguar; ▶ Kapacitetet e DKA-s në identifikimin dhe eliminimin e barrierave të qasjes në arsim, adresimin e dhunës, braktisjes dhe mos-regjistrimit; ▶ Strategjitë dhe mjetet për EPRBM-të komunale; ▶ Plani i veprimit për braktisje dhe reagim ndaj braktisjes dhe mosregjistrimit të fëmijëve në shkolla
14:00-14:30	Pauza
14:30-15:30	<p>Monitorimi dhe vlerësimi, mbështetja dhe raportimi për EPRBM</p> <ul style="list-style-type: none"> ▶ Monitorimi i punës së EPRBM në nivel shkolle; ▶ Mbështetja e EPRBM në nivel shkolle; ▶ Vlerësimi dhe raportimi për punën e EPRBM në nivel shkolle dhe në nivel komunal
15:30-16:00	<p>Hapat e mëtejme</p> <ul style="list-style-type: none"> ▶ Plani dinamik i punës 2021 për mbështetjen e shkollave në funksionalizimin e EPRBM ▶ Konstatimet përmbyllëse

Sesioni i hapjes së punëtorisë

Hapja e punëtorisë fokusohet në informacione hyrëse lidhur me kontekstin e organizimit dhe qëllimin e punëtorisë, informimin e pjesëmarrësve për agjendën e punëtorisë. Në sesionin e hapjes pjesëmarrësit informohen me temat që trajtohen gjatë punëtorisë, si dhe prezantojnë përvojën e tyre të deritanishme në mbështetjen e shkollave për sigurim të cilësisë, identifikimin dhe eliminimin e pengesave në arsim, mbrojtje të fëmijës, parandalim të dhunës, braktisjes dhe mosregjistrimit të shkollës.

Kohëzgjatja: 30 minuta

Çështjet kryesore	Rezultatet e pritura	Metodologjia	Burimet
Konteksti i organizimit të punëtorisë; Qëllimi i punëtorisë Agjenda e punëtorisë Prezantimi i pjesëmarrësve dhe pritjeve të tyre	Pjesëmarrësit e kanë të qartë qëllimin e punëtorisë dhe arsyeshmërinë e organizimit të saj; Pjesëmarrësit dhe fasilituesit e punëtorisë pajtohen për temat, agjendën dhe çështjet kryesore që lidhen me organizimin e punëtorisë	Prezantim Reflektime individuale nga pjesëmarrësit Diskutime	Plani dinamik i punës kundër braktisjes dhe mosregjistrimit të shkollës për vitin 2021 Agjenda e punëtorisë me DKA

Tema 1: Problemi i punës së fëmijëve: ndërlidhja me braktisjen e shkollës dhe cilësinë e arsimit

Informacionet përmbledhëse nga kjo temë kanë për qëllim të ndihmojnë Koordinatorët e cilësisë në DKA dhe udhëheqësit e EPRBM-ve në nivel komunal, për të kuptuar problemin e punës së fëmijëve, lidhjen e këtij problemi me braktisjen e shkollës dhe cilësinë e arsimit. Gjithashtu, kjo temë ofron edhe informacione për sistemin e mbrojtjes së fëmijëve, diskutime interaktive duke bërë një ndërlidhje se si mund t'i shërbejnë këtij sistemi Koordinatorët e cilësisë në DKA dhe EPRBM në nivel komunal, përmes:

- Krijimit të kushteve për vijueshmëri, qasje të fëmijëve/nxënësve në mësim dhe mbrojtje të fëmijës;
- Realizimit të praktikave të mbështetjes së shkollave në mbrojtje të fëmijës, parandalim të dhunës, braktisjes dhe mosregjistrimit të shkollimit; etj.

Çështjet kryesore që trajtohen në kuadër të kësaj teme, rezultatet e pritura, metodologjia e punës dhe burimet e referimit për trajtimin e kësaj teme, janë dhënë në tabelën e mëposhtme.

Kohëzgjatja: 30 minuta

Çështjet kryesore	Rezultatet e pritura	Metodologjia	Burimet
<p>Problemi i punës së fëmijëve: Si ndikon puna e fëmijëve dhe cilësia e arsimit në braktisjen e shkollës nga fëmijët? Format më të këqija dhe të rrezikshme të punës së fëmijëve</p> <p>Barrierat e qasjes në arsim</p> <p>Sistemi i mbrojtjes së fëmijëve: Si mund ti kontribuoj këtij sistemi</p> <p>DKA, EPRBM në nivel komunal?</p>	<p>Pjesë marrë sit në punë tori janë në gjendje të : Përshkruajnë problemin e punës së fëmijëve dhe ndërlidhjen e tij me cilësinë e arsimit, braktisjen e shkollës;</p> <p>Identifikojnë format më të këqija dhe të rrezikshme të punës së fëmijëve dhe barrierat e qasjes në arsim</p> <p>Identifikojnë mundësitë dhe veprimet që mund ti ndërmarrin për ti kontribuar sistemit të mbrojtjes së fëmijës, në bazë të rolit që kanë;</p>	<p>Prezantim</p> <p>Diskutime</p> <p>Informata kthyes mbi çështje specifike të ngritura nga pjesëmarrësit në punëtorit lidhur me sistemin e mbrojtjes së fëmijës</p>	<p>Strategjia dhe plani i veprimit për parandalimin dhe eliminimin e punës së fëmijëve në Kosovë 2011 – 2016 (2010)</p> <p>Fëmijët jashtë shkollës – Studim bazë për praktikën e parandalimit dhe të reagimit ndaj braktisjes dhe mosregjistrimit në shkollë (2014);</p> <p>Raporti përmbledhës për obligimet e institucioneve arsimore në Parandalimin dhe eliminimin e formave të rrezikshme të punës së fëmijëve (shtojca 1)</p>

Tema 2: Korniza e politikave arsimore për mbrojtjen e fëmijëve në Kosovë

MASHTI bazuar në politikat për mbrojtje të fëmijës dhe përmes mekanizimit për parandalim dhe reagim kundër dhunës, braktisjes dhe mosregjistrimit në shkollë angazhohet për sigurimin e cilësisë në arsimin parauniversitar, kultivimin e një sistemi jodiskriminues të arsimit, me qëllim rritjen e sigurisë dhe mirëqenies së secilit nxënës, mbrojtjen e grupeve të ndjeshme, si dhe angazhohet për të avancuar masat për parandalimin e braktisjes.

Në këtë sesion, përmes kësaj teme, synohet një informim më i plotë i Koordinatorëve të cilësisë në DKA dhe EPRBM në nivel komunal, lidhur me kornizën e politikave arsimore që referojnë mbrojtjen e fëmijës, masat për parandalim dhe reagim kundër dhunës, braktisjes dhe mosregjistrimit të fëmijëve/nxënësve në arsimin parauniversitar, përmbajtjen e modulit për Sistemin e Paralajmërimit të Hershëm (SPH) të braktisjes në SMIA, si dhe doracakët e zhvilluar për EPRBM dhe qëllimin e tyre.

Brenda konceptit të mbrojtjes së fëmijëve, trajtohet edhe roli i shkollës në zbatim të Protokollit 21/2013 për parandalim dhe referim të dhunës në shkollë, mbrojtja e fëmijëve gjatë përdorimit të internetit, si dhe parandalimi i dukurive negative që e sfidojnë pjesëmarrjen e fëmijëve në arsimim dhe zhvillimin e tyre të plotë, si në aspekt fizik, intelektual, emocional dhe social. Këtë qasje e ofron edhe kjo temë dhe sesioni i trajnimit për këtë temë, e cila ka për qëllim t'i udhëzojë pjesëmarrësit për të kuptuar sistemin e mbrojtjes së fëmijëve si tërësi dhe mënyrën se si arrihet kjo duke marrë për bazë aspektet e ngritura më sipër.

Çështjet kryesore që trajtohen në kuadër të kësaj teme, rezultatet e pritura, metodologjia e punës dhe burimet e referimit për trajtimin e kësaj teme, janë dhënë në tabelën e mëposhtme.

Kohëzgjatja: 60 minuta

Çështjet kryesore	Rezultatet e pritura	Metodologjia	Burimet
<p>Politikat dhe programet që referojnë mbrojtjen e fëmijës</p> <p>Planet strategjike;</p> <p>Protokolli për parandalimin dhe referimin e dhunës në institucionet e arsimit parauniversitar</p> <p>Udhëzimi Administrativ për EPRBM</p> <p>Moduli për Sistemin e Paralajmërimit të Hershëm (SPH) të braktisjes në SMIA;</p> <p>Doracakët për EPRBM;</p>	<p>Pjesëmarrësit në punëtori, marrin informim të plotë lidhur me:</p> <p>kornizën e politikave arsimore që referojnë mbrojtjen e fëmijës, masat për parandalim të dhunës në shkollë, parandalim dhe reagim kundër braktisjes dhe mosregjistrimit të fëmijëve/nxënësve në arsimin parauniversitar; masat dhe veprimet që janë ndërmarrë nga EPRBMSH në nivel qendror për braktisjen e shkollës; mundësitë e referimit në modulin për SPH dhe doracakët për EPRBM gjatë punës së tyre;</p>	<p>Prezantim</p> <p>Informata kthyesë mbi çështje specifike të ngritura lidhur me masat për parandalim dhe reagim kundër braktisjes dhe mosregjistrimit të fëmijëve/nxënësve në arsimin parauniversitar</p> <p>Diskutime</p>	<p>Udhëzimi administrativ 08/2018 për krijimin dhe fuqizimin e ekipeve për parandalim dhe reagim ndaj braktisjes dhe mosregjistrimit në arsimin parauniversitar</p> <p>Rregullorja QRK- nr. 21/2013 për protokollin për parandalimin dhe referimin e dhunës në institucionet e arsimit para-universitar</p> <p>https://masht.rks-gov.net/uploads/2015/06/rregullore-grk-nr-21-2013-per-protokol-lin-per-parandalimin-dhe-referim.pdf</p> <p>Plani dinamik i punës kundër braktisjes dhe mosregjistrimit të shkollës (2021)</p> <p>Mundësi të Barabarta për arsim për të gjithë - Doracakët për ekipet shkollë dhe komunale për parandalim dhe reagim ndaj braktisjes dhe mosregjistrimit në arsimin e obliguar (2014)</p> <p>https://masht.rks-gov.net/uploads/2015/12/doracak-per-ekipet-shkollore-per-parandalim_1.pdf</p> <p>https://masht.rks-gov.net/uploads/2015/12/doracak-per-ekipet-komunale-per-parandalim_1.pdf</p>

Tema 3:Kuatridhe pakoja e dokumenteve për sigurimin e cilësisë në arsimin parauniversitar që lidhen me rolin e DKA

Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI), në vitet e fundit ka zhvilluar një numër të politikave arsimore që lidhen me sigurimin e cilësisë në parauniversitar, përfshirë pakon e dokumenteve që lidhen me performancën e shkollës, dokumentin e strategjisë së veçantë për sigurimin e cilësisë (2016-2020), integrimin e adresimin e saj në PSAK 2017-2021, udhëzime administrative të veçanta, vendosjen e mekanizmave të veçantë në nivel të institucioneve arsimore për sigurim të cilësisë, etj. Miratimi i Ligjit për Inspektoratin e Arsimit, është një zhvillim tjetër në këtë fushë.

Këto aspekte i mbulon kjo temë, e cila ka për qëllim të udhëzojë pjesëmarrësit lidhur me sistemin për sigurim të cilësisë në arsimin parauniversitar, përfshirë legjisllacionin bazë dhe dokumentet për sigurimin e cilësisë, funksionimin e mekanizmave për sigurim të cilësisë, si dhe rolin e Drejtorive Komunale të Arsimit në këtë proces.

Tabela e mëposhtme ofron një pasqyrë të çështjeve kryesore që trajtohen lidhur me këtë temë, në kuadër të këtij sesi, rezultatet e pritura, si dhe orientimet për metodologjinë e punës dhe burimet e referimit për trajtimin e kësaj teme.

Kohëzgjatja: 30 minuta

Çështjet kryesore	Rezultatet e pritura	Metodologjia	Burimet
<p>Aspektet kryesore që lidhen me sistemin e sigurimit të cilësisë në arsimin parauniversitar;</p> <p>Legjislatiioni bazë dhe dokumentet për sigurimin e cilësisë;</p> <p>Mekanizmat për sigurim të cilësisë;</p> <p>Roli i DKA-së në sigurimin e cilësisë:</p> <p>Funksionalizimi i KSC në nivel shkolle Vlerësimi i performancës së shkollës Proceset e planifikimit zhvillimor të institucioneve arsimore Mbështetja e shkollave në sigurimin e cilësisë</p>	<p>Pjesëmarrësit në punëtori, marrin informim dhe thellojnë të kuptuarit e tyre për: kornizën e politikave arsimore për sigurimin e cilësisë në arsimin parauniversitar; mekanizmat për sigurim të cilësisë; rolin e DKA-së në sigurimin e cilësisë</p>	<p>Prezantim</p> <p>Diskutime</p> <p>Informata kthyesë mbi çështje specifike të ngritura nga pjesëmarrësit në punëtori</p> <p>Reflektimi individual nga pjesëmarrësit</p>	<p>Strategjia e Sigurimit të Cilësisë për Arsimin Parauniversitar në Kosovë 2016-2020 (2015)</p> <p>Plani Strategjik i Arsimit në Kosovë 2017-2021;</p> <p>Korniza për sigurim të cilësisë së performancës së shkollës në Kosovë (2016);</p> <p>UA nr. 24/2016: Sigurimi i cilësisë në Arsimin Parauniversitar.</p> <p>UA nr. 04/2017: Vlerësimi i performancës në Institucionet e Arsimore</p>

Tema 4:Roli i DKA në krijimin e kushteve për vijueshmëri, qasje të fëmijëve/nxënësve në mësim dhe mbrojtje të fëmijës

Komunat duke u bazuar në kuadrin ligjor dhe politikat tjera arsimore, kanë përgjegjësi të veçanta në menaxhimin e arsimit në nivel komunal, krijimin e kushteve për vijueshmëri, qasje të fëmijëve/nxënësve në mësim dhe mbrojtje të fëmijës, koordinimin e masave me mekanizmat tjerë në nivel të komunës dhe MASHTI-it në adresimin e këtyre barrierave, si dhe në mbështetjen e shkollave në procesin e mësimor dhe në zhvillimit të saj. Detyrimet dhe përgjegjësitë e komunës në këtë fushë shtrihen në sektorët e komunës dhe tek mekanizmat e brendshëm siç janë DKA dhe EPRBM. Funksionalizimi i EPRBM është i lidhur me procesin e njohjes dhe të kuptuarit e përbashkët të rolit të EPRBM, të parimeve mbështetëse në punën e EPRBM dhe të detyrave të gjitha EPRBM, por edhe të marrjes së përgjegjësi për ta përbushur këtë rolin dhe detyrat EPRBM në nivel komune.

Në këtë sesion, krahas informacioneve, udhëzimeve, diskutimeve e shkëmbimit të përvojave për ushtrimin e rolit të EPRBM-ve të komunave, do të ketë informacione, udhëzime dhe orientime edhe për kapacitetet e DKA-s në identifikimin dhe eliminimin e barrierave të qasjes në arsim, adresimin e dhunës, braktisjes dhe mos-regjistrimit; Strategjitë dhe mjetet për EPRBM-të komunale; si dhe qasjet në përgatitjen e Planit të veprimit në nivel komunal për braktisje dhe reagim ndaj braktisjes dhe mosregjistrimit të fëmijëve në shkolla

Tabela e mëposhtme ofron një pasqyrë të çështjeve kryesore që trajtohen lidhur me këtë temë, në kuadër të këtij sesioni, rezultatet e pritura, si dhe orientimet për metodologjinë e punës dhe burimet e referimit për trajtimin e kësaj teme.

Kohëzgjatja: 30 minuta

Çështjet kryesore	Rezultatet e pritura	Metodologjia	Burimet
Roli i EPRBM komunale në parandalimin, reagimin dhe trajtimin adekuat të problemit të braktisjes dhe mos-regjistrimit në arsimin e obliguar; Kapacitetet e DKA-s në identifikimin dhe eliminimin e barrierave të qasjes në arsim, adresimin e dhunës, braktisjes dhe mos-regjistrimit; Strategjitë dhe mjetet për EPRBM-të komunale; Plani i veprimit për braktisje dhe reagim ndaj braktisjes dhe mosregjistrimit të fëmijëve në shkolla	Pjesëmarrësit e kanë të qartë dhe janë në gjendje të: Përshkruajnë rolin e DKA dhe EPRBM në parandalimin, reagimin dhe trajtimin adekuat të problemit të braktisjes dhe mos-regjistrimit në arsimin e obliguar; Analizojnë aspektet që lidhen me punën e EPRBM në komunale; Përcaktojnë strategjitë dhe mjetet për EPRBM bazuar në kontekstin e komunave prej nga vijnë; Caktojnë objektivat për përfshirje në planin komunal të veprimit për braktisje dhe reagim ndaj braktisjes dhe mosregjistrimit të fëmijëve në shkolla	Prezantim Diskutime Informata kthyesë mbi çështje specifike të ngritura Punë në çifte Prezantime dhe diskutim i përbashkët.	Udhëzimi administrativ 08/2018 për krijimin dhe fuqizimin e ekipeve për parandalim dhe reagim ndaj braktisjes dhe mosregjistrimit në arsimin parauniversitar Rregullorja QRK- nr. 21/2013 për protokollin për parandalimin dhe referimin e dhunës në institucionet e arsimit para-universitar https://masht.rks-gov.net/uploads/2015/06/rregullore-qrk-nr-21-2013-per-protokollin-per-parandalimin-dhe-referim.pdf Mundësi të Barabarta për arsim për të gjithë – Doracaku për ekipet komunale për parandalim dhe reagim ndaj braktisjes dhe mosregjistrimit në arsimin e obliguar (2014) https://masht.rks-gov.net/uploads/2015/12/doracak-per-ekipet-komunale-per-parandalim_1.pdf https://masht.rks-gov.net/uploads/2019/03/ua-nr-01-2019-per-mbrojtjen-e-femijeve-nxeneseve-ne-int-ne-ins-e-apu.pdf

Tema 5: Monitorimi dhe vlerësimi, mbështetja dhe raportimi për EPRBM

Kjo teme përqendrohet në aspektet kryesore që lidhen me monitorimin e punës së EPRBM në nivel shkollor, mbështetjen e EPRBM në nivel shkollor dhe raportimin për punën e EPRBM në nivel shkollor dhe në nivel komunal. Gjithashtu, kjo temë ofron informata dhe shembuj të veprimeve që mund të ndërmerren nga EPRBM në nivel komune për procesin përgatitor të monitorimit, mbështetjes dhe raportimit për punën e EPRBM, vizitat në shkolla dhe takimet e drejtpërdrejta dhe online me EPRBM shkollor, formën e raportimeve të EPRBM dhe qëllimet e përdorimit të raporteve, mbështetjen dhe dokumentimin e punës së EPRBM.

Çështjet kryesore që trajtohen në kuadër të kësaj teme, rezultatet e pritura, metodologjia e punës dhe burimet e referimit për trajtimin e kësaj teme, janë dhënë në tabelën e mëposhtme.

Kohëzgjatja: 60 minuta

Çështjet kryesore	Rezultatet e pritura	Metodologjia	Burimet
<p>Përvojat e EPRBM monitorimin, mbështetjen e shkollave dhe raportimet për punën e bërë nga EPRBM: Çfarë është bërë dhe si është bërë lidhur me punën e EPRBM? Monitorimi dhe vlerësimi i punës së EPRBM në nivel shkolle; Mbështetja e EPRBM në nivel shkolle; Raportimi takimet dhe aktivitetet e realizuara nga EPRBM Dokumentimi</p>	<p>Pjesëmarrësit janë në gjendje të: Shkëmbejnë përvojat për qasjet që kanë ndjekur në monitorimin, mbështetjen e shkollave dhe raportimet për punën e bërë nga EPRBM; Shfrytëzojnë praktikën e mira për të dhënë ide rreth përgatitjeve për monitorimin, mbështetjen e shkollave dhe raportimet për punën e bërë nga EPRBM; Përdorin udhëzimet e modulit të trajnimit për të vendosur për monitorimin, mbështetjen e shkollave dhe raportimet në të ardhmen për punën e bërë nga EPRBM;</p>	<p>Reflektime individuale nga pjesëmarrësit Prezantim Punë në çifte Diskutime të strukturuar Informata kthyese mbi çështje specifike të ngritura</p>	<p><i>Mundësi të Barabarta për arsim për të gjithë - Doracakët për ekipet shkollore dhe komunale për parandalim dhe reagim ndaj braktisjes dhe mosregjistrimit në arsimin e obliguar (2014)</i></p> <p><i>Foracaku për qeverisjen e arsimit në komuna (2017)</i></p> <p><i>Udhëzuesit për vlerësim të performancës së shkollës (2017)</i></p>

Sesioni përmblyës i punëtorisë


Sesioni përmblyës i punëtorisë mundëson reflektime individuale nga përvojat dhe mësimet e marra gjatë punëtorisë, konstatime përmblyëse lidhur me përmbushjen e qëllimit të punëtorisë dhe rezultateve të pritura. Gjithashtu, në këtë sesion rikthehet diskutimi për planin dinamik të punës kundër braktisjes dhe mosregjistrimit të shkollës për vitin 2021 dhe për hapat e mëtejme që do të ndërmarrin Koordinatorët e cilësisë në DKA dhe udhëheqësit e EPRBM-ve në nivel komunal për siguruar qëndrueshmërinë e mekanizimit të EPRBM-ve në nivel shkolle dhe për të fokusuar punën e shkollave që përmes vlerësimit të brendshëm të shkollës, të vlerësojnë edhe arrijtjet për parandalim dhe reagim ndaj braktisjes dhe mosregjistrimit dhe nevojat për mbështetje në këtë fushë.

Kohëzgjatja: 30 minuta

Çështjet kryesore	Rezultatet e pritura	Metodologjia	Burimet
<p>Hapat e mëtejme Plani dinamik i punës së KC dhe EPRBM në nivel komunal; Konstatimet përmblyëse</p>	<p>Pjesëmarrësit në punëtori janë në gjendje të: Vendosin për hapat që do të ndërmarrin në funksionalizimin e mekanizmave të shkollës (EPRBM dhe KC), mbështetjen dhe mbikëqyrjen e punës së tyre; Prezantojnë mësimet nga punëtori;</p>	<p>Prezantim Reflektime individuale nga pjesëmarrësit Diskutim</p>	<p>Konstatimet përmblyëse</p> <p>Plani dinamik i punës kundër braktisjes dhe mosregjistrimit të shkollës për vitin 2021</p>

▶ 3

Materiale plotësuese dhe udhëzime



3.1. Problemi i punës së fëmijëve, lidhja e problemit me braktisjen e shkollës dhe cilësinë e arsimit

Referuar Ligjit për Mbrojtje të Fëmijëve, puna e fëmijëve është puna që dëmton mirëqenien e fëmijës dhe pengon arsimin dhe zhvillimin e tij ose saj si dhe standardin e ardhshëm jetësor. Puna e fëmijëve është punë e cila për nga natyra dhe/ose mënyra si kryhet, dëmton, abuzon dhe shfrytëzon fëmijën dhe i mohon të drejtën e fëmijës për arsimim.

Faktorët që shkaktojnë punën e fëmijëve që përshkruhen në raporte dhe dokumente të ndryshme, kryesisht lidhen me gjendjen ekonomike, arsimin dhe normat sociale. Të tre këta faktorë lidhen me faktorët e rrezikut për mosregjistrim, mosvijim dhe braktisje të shkollës të identifikuar dhe përshkruar në doracakët për EPRBM, ata janë: faktorët familjarë, faktorët shkollorë dhe faktorët socialë.

Edhe në dokumentin Strategjia dhe plani i veprimit për parandalimin dhe eliminimin e punës së fëmijëve në Kosovë 2011 – 2016 (2010), angazhimi në punë i fëmijëve/ nxënësve braktisës dhe performanca e ulët e nxënësve, renditën ndër faktorët kryesorë që ndikojnë në braktisje të shkollimit. Sipas kësaj strategjie, **përpyekja për të siguruar arsim cilësor dhe për të gjithë fëmijët është bazë e të gjitha përpjekjeve për eliminimin e punës së fëmijëve.**

Prandaj është e rëndësishme që DKA-të:

- të informohen dhe thellojnë të kuptuarit e tyre lidhur me problemin e punës së fëmijëve dhe ndërlidhjen e tij me cilësinë e arsimit, braktisjen e shkollës;
- të posedojnë listën e institucioneve që kanë role dhe përgjegjësi në adresimin e punës së fëmijëve dhe të intensifikojnë bashkëpunimin institucional për informim reciprok dhe koordinim të veprimeve;
- të mbikëqyrin dhe mbështesin vlerësimin e brendshëm të performancës së shkollës, në mënyrë që të performanca e shkollës në mbrojtje të fëmijëve dhe parandalim të braktisjes të trajtohet në nivelin e nevojshëm

dhe të shërbej si bazë për përmirësim të vazhdueshëm dhe

- të identifikojnë mundësitë dhe veprimet që mund ti ndërmarrin për ti mbështetur shkollat në identifikimin e barrierave të qasjes në arsim dhe eliminimit të tyre.

Format më të këqija të punës së fëmijëve

Dimensionin i përcaktimit të formave më të këqija të punës së fëmijëve buron nga Konventa 182 e ILO-së për Format më të Këqija të Punës së Fëmijëve dhe nga politikat shtetërore për mbrojtjen e fëmijës. Referuar këtyre dokumenteve, DKA-të duhet të njohin format më të këqija të punës së fëmijëve, në mënyrë që gjatë monitorimit të zbatimit të politikave për mbrojtjen e fëmijës nga institucionet arsimore, ti kenë për bazë dhe ti referohen atyre gjatë mbikëqyrjes dhe mbështetjes së punës së shkollave lidhur me këtë fushë.

Format më të këqija të punës së fëmijëve:

- a. të gjitha format e skllavërisë ose praktikave të ngjashme me skllavërinë, të tilla si shitja dhe trafikimi i fëmijëve, detyrimi i skllavërues dhe bujkrobëria dhe puna pa dëshirë ose e detyruar, përfshirë rekrutimi pa dëshirë ose të detyruar për përdorim në konflikte të armatosura;
- b. përdorimin, kërkimin ose dhënien e një fëmije për prostitucion, për prodhim pornografie ose për shfaqje pornografike;
- c. përdorimin, kërkimin ose dhënien e një fëmije për veprimtari të paligjshme, në veçanti për prodhimin dhe trafikimin e drogave narkotike sikundër janë përkufizuar në traktatet përkatëse ndërkombëtare;
- d. punët të cilat, nga natyra ose rrethanat në të cilat kryhen mund të rrezikojnë shëndetin, sigurinë ose moralin e fëmijëve.

Format e rrezikshme të punës së fëmijëve në Kosovë

Kategoria e katërt (d) cilësohet si punë e rrezikshme e fëmijëve dhe i referohet punës që ka gjasa të rezultojë në vdekjen e fëmijës,

lëndimin (shpeshherë për gjithë jetën) ose sëmurjen (shpeshherë për gjithë jetën) për shkak të natyrës së punës ose si pasojë e vendit jo të sigurt të punës, standardeve të ulëta të sigurisë dhe shëndetit dhe kushteve dhe rregullimeve të punës. Sa i përket kësaj kategorie, versioni i parë i listës së punëve të rrezikshme për fëmijë në Kosovë është përgatitur me mbështetjen e ILO-së gjatë periudhës 2005-2007, dhe ka hyrë në fuqi ligjërisht si Udhëzim Administrativ i Qeverisë për Parandalimin dhe Eliminimin e Punëve të Rrezikshme për Fëmijë në Kosovë (UA 17/2008). Udhëzimi Administrativ rendit (a) sektorët e rrezikshëm dhe (b) aktivitetet e përgjithshme të rrezikshme që duhet të ndalohen si çështje parësore. Në vitin 2013, UA 17/2008 u zëvendësua me UA 05/2013, duke përditësuar listën e punëve të rrezikshme për fëmijë në Kosovë. Referuar UA 05/2013, aktivitetet e përgjithshme për ndalim të menjëhershëm janë si në vijim:

- Puna e natës (20:00 deri 06:00);
- Ngritja dhe bartja e peshave të rënda (ngritje dhe bartje e kohëpaskohshme mbi 15 kg për djem dhe mbi 10 kg për vajza; ngritje dhe bartje e vazhdueshme mbi 10 kg për djem dhe mbi 5 kg për vajza;
- Puna në thellësi, nën sipërfaqe të tokës, nën ujë dhe mjedise të mbyllura
- Puna në lartësi (mbi 2 m);
- Ekspozimi ndaj temperaturave ekstreme, ndaj zhurmës dhe dridhjes;
- Ekspozimi ndaj substancave të rrezikshme (toksike, biologjike, radioaktive, kancerogjene, pluhurit dhe gazrave);

Sektorët për ndalim të menjëhershëm

- Puna në sektorin e bujqësisë dhe pylltarisë
- Puna në rrugë
- Puna në deponi të mbeturinave
- Puna në eksploatimin e pasurive natyrore
- Puna në ndërtimtari

Barrierat e qasjes në arsim

Në raportin përmbledhës lidhur me përmbushjen e obligimeve për zbatimin e UA 05/2013 për Parandalimin dhe ndalimin e formave të rrezikshme të punës së fëmijëve në Kosovë, të përgatitur nga Koordinatorja për të Drejta të Njeriut në MASHTI, me përkrahje nga ILO, janë shpalosur disa barrierat e qasjes në arsim, si:

- Kushtet e vështira ekonomike në familje;
- Mungesa e shërbimeve profesionale në shkolla;
- Distanca e shkollave në vendet rurale (mungesa e transportit të organizuar);
- Mungesa e sigurisë gjatë rrugës në shkollë;
- Dhuna në shkollë;
- Prezenca e lokaleve në afërsi të shkollës;
- Qasja afirmative ndaj punës së fëmijëve dhe mungesa e vetëdijes për efektet negative në shëndetin dhe zhvillimin e fëmijës;
- Mungesa e bashkëpunimit të shkollës me institucionet e mirëqenies sociale për trajtimin e rasteve të fëmijëve të përfshirë në punë;
- Angazhimi i pamjaftueshëm i Drejtorive Komunale të Arsimit dhe mekanizmave relevant për adresimin e braktisjes së shkollës dhe punës së fëmijëve;
- Cilësia e Arsimit (kurrikula e stërngarkuar, metodologjia joadekuatë e punës me nxënës, mungesa e mjeteve mësimore dhe infrastrukturës së përshtatshme shkollore, punë me ndërrime).

Identifikimi barrierave të qasjes në arsim është vetëm një hap drejt adresimit të tyre nga institucionet që kanë role dhe përgjegjësi në këtë fushë. Pa dyshim, roli i institucioneve arsimore në adresimin e punës së fëmijëve është i rëndësishëm së veçantë. Në këtë mes hyjnë në radhë të parë MASHTI, pastaj DKA, Shkollat dhe Inspektorati i Arsimit. Dy perspektiva të trajtimit të punës së fëmijëve nga institucionet arsimore:

- Puna e fëmijëve si shkak i braktisjes;
- Puna e fëmijëve si pasojë e cilësisë së dobët të arsimit.

MASHT në fund të vitit 2013 (24.12.2013), ka miratuar raportin përmbledhës lidhur me obligimet e institucioneve arsimore (MASHTI, DKA dhe shkollat për zbatimin e Udhëzimit Administrativ QRK 05/2013 parandalimin dhe ndalimin e formave rrezikshme të punës së fëmijëve në Kosovë. **Shih shtojcën nr.1. në këtë modulit të trajnimit.**

3.2. Korniza e politikave arsimore për mbrojtjen e fëmijëve në Kosovë

E drejta në edukim tanimë është ripohuar disa herë që nga koha kur ishte shpallur për herë të parë në vitin 1948 përmes Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut (DUDNJ), më vonë e konkretizuar në Konventën e të Drejtave të Fëmijëve (KDF) në nenet 28 dhe 29. Këto traktate deklarojnë që të paktën arsimit fillor është falas dhe i detyrueshëm, ndërsa arsimit i mesëm dhe i lartë do të bëhen në mënyrë progresive të arritshme për të gjithë, edhe pse jo domosdoshmërisht falas. Neni 28 i KDF përcakton edukimin si e drejtë dhe rekomandon hapat për të arritur këtë të drejtë “në mënyrë progresive dhe mbi bazën e mundësive të barabarta”. Referuar këtyre përcaktimeve, nga sistemet arsimore kërkohet që të ndërmarrin hapat si në vijim²:

- Arsimit fillor duhet të jetë i detyrueshëm dhe falas për të gjithë;
- Arsimit i mesëm duhet të vihet në dispozicion dhe të jetë i arritshëm për çdo fëmijë, me ndihmën financiare në rast nevojë.
- Të inkurajojnë vijimin në shkollë dhe zvogëlimin e normës së braktisjes.

Dokumentet bazë që e rregullojnë arsimin parauniversitar në Kosovë, si Ligji për arsim Parauniversitar në Republikën e Kosovës (2011) dhe Korniza e Kurrikulës së Arsimit parauniversitar të Republikës së Kosovës (2011/ e rishikuar 2016), janë të ndërtuara mbi parimin e gjithëpërfshirjes në arsim, që në mënyrë të drejtpërdrejtë i referohet së drejtës së secilit fëmijë dhe të ri për përfshirje të barabartë në arsim cilësor. Referuar Ligjit për arsim parauniversitar në Republikën e Kosovës, arsimit parauniversitar është përgjegjësi e përbashkët e prindërve, institucioneve arsimore dhe aftësuese, komunave dhe qeverisë, sipas funksioneve dhe detyrave përkatëse të përcaktuara në këtë ligj³.

E drejta e secilit fëmijë dhe të ri për përfshirje të barabartë në arsim cilësor, obligon institucionet arsimore nga niveli qendror deri të shkolla që të ndërmarrin masa për parandalim dhe reagim kundër braktisjes dhe mosregjistrimit në arsimin parauniversitar. Në këtë drejtim, MASH ka hartuar bazë legjislative për parandalim dhe reagim kundër braktisjes dhe mosregjistrimit në arsimin parauniversitar, përfshirë akte nënligjore, vendosje të mekanizmit të EPRBM nga niveli qendror deri në nivel shkolle, doracakë dhe dokumentacion shoqëruar mbështetës për punën e EPRBM dhe për paralajmërim të hershëm të braktisjes në SMIA.

Aspektet e zbatimit në praktikë të masave për parandalim dhe reagim kundër dhunës në institucione arsimore, braktisjes dhe mosregjistrimit, janë adresuar edhe me plane strategjike, si në:

- PSAK 2011-2016 & PSAK 2017-2021;
- Strategjinë për integrimin e komuniteteve romë, ashkali dhe egjiptianë në Kosovë,
- Strategjinë për riintegrimin e personave të riatdhesuar;
- Protokollin për parandalimin dhe referimin e dhunës në institucionet e arsimit parauniversitar;

² Më gjerësisht, shih Modulin 1: E Drejta për Edukim - Edukimi Cilësor. Programi për ngritjen e kapaciteteve në Udhëheqjen Arsimore,

³ Instituti Pedagogjik i Kosovës (2014). Fëmijët jashtë shkollës – Studim bazë për praktikën e parandalimit dhe të reagimit ndaj braktisjes dhe mosregjistrimit në shkollë.

- Udhëzuesi për zbatimin e Rregullores së QRK-nr. 21/2013 për protokollin për parandalimin dhe referimin e dhunës në institucionet e arsimit parauniversitar⁴;
- Planin e veprimit kundër braktisjes dhe mosregjistrimit të shkollës, etj.

Bazuar në planet strategjike, janë zhvilluar plane të veprimit dhe janë realizuar një mori e aktiviteteve dhe projekteve lidhur me parandalimin e braktisjes dhe mosregjistrimin e fëmijëve në arsimin parauniversitar, përfshirë themelimin dhe koordinim e aktiviteteve me EPRBM nga niveli qendror deri në nivel të shkollës.

Krahas themelimit të EPRBM, MASH ka mbështetur ngritjen e kapaciteteve të tyre me përkrahje nga partnerët që mbështesin arsimin në Kosovë, si UNICEF, ECMI, KEC, GIZ, përmes trajnimeve, punëtorive dhe udhëzuesve për EPRBM në nivel shkolle dhe komune. EPRBM në nivel nacional ka mbështetur komunat dhe shkollat duke mentoruar e këshilluar në lidhje me funksionimin sa më të mirë të ekipeve të tyre në bashkëveprimin me sektorët tjerë në nivele komunale (QMF, QPS, PK, KPAK, KPA, KN, dhe OJQ,)

Me qëllim të koordinimit më të mirë dhe arritjes së rezultateve në parandalimin e braktisjes dhe të mosregjistrimit të shkollës, MASHTI në bashkëpunim me UNICEF ka zhvilluar modulën e Sistemit për Paralajmërim të Hershëm (SPH) në kuadër të Sistemit të menaxhimit të informatave në arsim (SMIA). Zhvillimi i këtij moduli u mundëson shkollave /EPRBM që ti identifikojnë fëmijët që janë në rrezik të braktisjes së shkollës, ti raportojnë rastet dhe në varësi të faktorëve ndikues të ndërmarrin masa parandaluese.

Krahas udhëzuesve për EPRBM, Moduli për Sistemin për Paralajmërim të Hershëm (SPH), janë hartuar edhe manualët didaktike, si:

- Manuali didaktik për parandalimin e dhunës në shkolla;

- Manuali për parandalim të dukurive negative në shkolla të mesme të larta;
- Udhëzuesit për mbrojtjen e fëmijëve në internet;

Me gjithë progresin e arritur në konsolidimin e EPRBM për identifikim, raportim dhe referim të rasteve të braktisjes dhe mosregjistrimit, në krijimin e mundësisë së raportimit në Sistemin e Paralajmërimit të Hershëm të braktisjes, brenda Sistemit të Menaxhimit të Informatave në Arsim, akoma nuk është bërë fuqizimi i mekanizmave për monitorimin, mentorim dhe mbikëqyrjen e zbatimit të platformës për parandalim dhe reagim ndaj braktisjes.

Në mungesë të monitorimit sistematik të gjithë mekanizmave që lidhen me punën e EPRBM, pika më e ndjeshme vazhdon të jetë raportimi në të gjitha nivelet e arsimit:

- Raportimi në nivel vendi
- Raportimi tek mekanizmat ndërkombëtar
- Baza e të dhënave/ indikatorët/ Cilësia e të dhënave
- Raportimi bazuar në dëshmi/ Orientimi i politikave

Angazhimi i vazhdueshëm i mekanizmave të DKA-ve i kontribuon arritjes së rezultateve të pritshme dhe zbatimit efikas të politikave arsimore dhe politikave tjera për mbrojtjen e fëmijëve që lidhen me punën e institucioneve arsimore. Mbështetja e shkollave dhe monitorimi nga DKA dhe mekanizmat tjerë të MASHTI-it, siç është Inspektorati i Arsimit mundëson që të kemi:

- Mekanizma koordinues funksional në nivel qendror, komunal dhe në nivel shkolle
- Sistem funksional i paralajmërimit të hershëm të braktisjes, parandalim të dhunë dhe dukurive negative

⁴ Protokollin është fryt i koordinimit ndërinstitucional. Protokollin mundëson:

- Qasjen ndërinstitucionale dhe multidimensionale
- Konsolidimin e sistemin të raportimit dhe referimit të rasteve
- Orientimin e politikave bazuar në dëshmi

- Vetëdije e ngritur e institucioneve shkollore dhe komunale për adresimin sistemor të problemeve që e sfidojnë zhvillimin e fëmijëve.
- Rritje e cilësisë së të dhënave për fëmijët braktisës dhe ata që janë në rrezik për braktisje, rastet e dhunës...
- Rritje të regjistrimit në shkollë/ zvogëlim të braktisjes.
- Rritje të llogaridhënies, respektim të drejtave të njeriut/fëmijëve.

Grupi për Parandalim dhe Reagim ndaj Braktisjes dhe Mosregjistrimit të Shkollës në nivel të MASHTI, nuk kuadër të angazhimeve të tij, në vitin 2017, ka hartuar raportin përmbledhës mbi gjetjet nga monitorimi dhe mentorimi i DKA-ve dhe shkollave, lidhur me funksionimin e EPRBMSH. Raporti përmbledh anën legislative dhe operative të punës së MASHTI me partnerët e vet si dhe gjetjet nga procesi i monitorimit dhe mentorimit në 21 komuna të Republikës së Kosovës, mbi zbatimin e politikave kundër braktisjes së shkollimit në praktikën e përditshme të shkollave, dhe DKA-ve. ***Më gjerësisht shih një përmbledhje të raportit në shtojcën nr. 2 të këtij moduli të trajnimit.***

Konceptet kryesore për mbrojtje të fëmijës, dhunën mosregjistrimin në shkollë dhe braktisjen e shkollimit

Në politikat arsimore që referojnë mbrojtjen e fëmijës, parandalimin e dhunës, si dhe në doracakët për ekipet shkollore dhe ekipet komunale për parandalim dhe reagim ndaj braktisjes dhe mosregjistrimit në arsimin e obliguar, janë dhënë disa përkufizime që lidhen me konceptet kryesore. Ato ndihmojnë shkollat, EPRBM dhe mbikëqyrësit e punës së tyre që të qartësojnë mirë specifikat dalluese të koncepteve gjatë punës në adresimin e problemeve që lidhen me parandalimin e dhunës, parandalimin e mosregjistrimit dhe braktisjen e shkollimit.

- **Fëmijë**- nënkupton çdo qenie njerëzore nën moshën 18 vjeç, me përjashtim të rasteve kur moshë madhore arrihet më përpara, në përputhje me legjislacionin të cilit ai i nënshtrohet;
- **Dhunë**- nënkupton: "Te gjitha format fizike dhe/ose emocionale të keqtrajtimit,

shpërdorimit seksual, neglizhencës apo trajtimit neglizhent, shfrytëzimit komercial ose çdo lloj shfrytëzimi që ka si rezultat dëmtimin e mundshëm apo të vërtetë të shëndetit, mbijetesës, zhvillimit apo të dinjitetit të fëmijës në kontekst të raportit të përgjegjësisë, besimit, apo forcës";

- **Mbrojtja e fëmijës** - nënkupton parandalimin dhe përgjigjen ndaj dhunës, keqtrajtimit, abuzimit, shfrytëzimit dhe neglizhimit, rrëmbimit, shfrytëzimit seksual, trafikimit dhe punës së fëmijës në dhe jashtë shtëpisë
- **Fëmijët e moshës shkollore** – arsimit të detyruar, por që nuk janë regjistruar dhe nuk e vijnë shkollimin;
- **Fëmijët në rrezik për ta braktisur shkollimin** - janë fëmijë që janë regjistruar dhe po e vijnë shkollën, por që për arsye të ndryshme, mund ta lënë shkollën pa përfunduar klasën e nëntë;
- **Fëmijët e moshës shkollore të cilët e braktisin shkollimin para kryerjes së arsimit të detyruar** /klasës së 9-të/ - janë fëmijë në moshën e arsimit të detyruar që janë regjistruar dhe e kanë vijuar shkollën, por, në një periudhë, e kanë braktisur atë;
- **Adoleshentët dhe të rinjtë të cilët e kanë kryer klasën e 9-të, por e kanë braktisur shkollimin në nivelin e arsimit të mesëm të lartë** - janë regjistruar në arsimin e mesëm të lartë, e vijnë atë, por që për arsye të ndryshme, mund ta lënë shkollën pa përfunduar klasën e fundit të arsimit të mesëm të lartë.

Hapi tjetër i veprimit, lidhet me njohjen dhe të kuptuarit e shkaqeve dhe arsyeve të mosregjistrimit të fëmijëve në shkollë dhe të braktisjes së shkollimit.

Faktorët që ndikojnë në mosregjistrimin dhe braktisjen e shkollimit

Ashtu si për konceptet kryesore, edhe për faktorët që ndikojnë në mosregjistrimin dhe braktisjen e shkollimit, në doracakët për ekipet shkollore dhe ekipet komunale për parandalim dhe reagim ndaj braktisjes dhe mosregjistrimit në arsimin e obliguar, janë listuar një varg faktorësh që ndikojnë në braktisjen e shkollimit, si:

Faktorët individualë: Sëmundjet e ndryshme, aftësitë e kufizuara, martesë e hershme, përkrahja e vogël nga familja, përfshirja në dukuri negative, përdorimi i narkotikëve, qasja individuale ndaj arsimit, etj.

Faktorët familjarë: Mungesa e kujdesit adekuat prindëror (pa të dy ose njërin prind dhe shkurorëzimet), niveli i arsimimit të prindërve, mentaliteti kulturor i familjeve, mos-bashkëpunimi/mos-adaptimi i familjes me rrethin; fëmijët si mbajtës të familjes, etj.

Faktorë shkollorë: Pozita gjeografike e shkollave (rreziqet gjatë udhëtimit sidomos në zonat malore), relacionet arsimtarë-nxënës dhe anasjelltas, nxënës-nxënës (sjelljet joadekuate, vlerësimet jokorrekte, dhuna, keqpërdorimi i teknologjisë informative, etj.), mungesa e shërbimeve adekuate profesionale në trajtimin e problemeve brenda shkollës, niveli jo i duhur i bashkëpunimit të shkollave me shërbimet e tjera komunale dhe me komunitetin, ndikimi i dukurive të jashtme negative, etj..

Faktorët socialë: Problemet sociale/varfëria, niveli jo i duhur i bashkëpunimit ndër-institucional dhe me komunitetin, dukuritë negative brenda shoqërisë, lëvizjet, migrimet, etj.

Detyra 1: Shkëmbim idesh për faktorët e mosregjistrimit të fëmijëve në shkollë dhe të braktisjes së shkollimit

Bazuar në faktorët e përshkruar më sipër dhe në përvojën tuaj dhe informacionet që ju keni për faktorët tjerë, identifikoni dhe diskutoni me kolegë faktorët që ndikojnë më shumë në mosregjistrimin e shkollës dhe faktorët që ndikojnë më shumë në braktisje të shkollimit apo në rrezik për braktisje. Arsyetoni me shembuj ilustrues adresimin e rasteve.

Faktorët që ndikojnë në mosregjistrimin e shkollës	Faktorët që ndikojnë në braktisje të shkollimit apo në rrezik për braktisje
Fëmija duhet të punojë për të mbështetur familjen	Fëmija duhet të punojë për të mbështetur familjen
Largësia e shtëpisë nga shkolla	Fëmija ka mungesat e shumta
Familja e fsheh fëmijën me nevoja të veçanta	Fëmija nuk është mirë në mësimet
.....

Kini kujdes!

Disa nga faktorët e mësipërm, mund të mos jenë relevantë për çdo rast të mosregjistrimit ose të braktisjes së shkollimit. Kjo do të thotë se secili rast ka historinë e vet për të cilën EPRBM duhet të mbledhin të dhëna dhe të nxjerrin përfundime për arsyet dhe masat që duhet ndërmarrë.

3.3. Kuadri ligjor dhe pakoja e dokumenteve për sigurimin e cilësisë në arsimin parauniversitar që lidhen me rolin e DKA

Në vitet e fundit në Kosovë është rritur përqendrimi në sigurimin e cilësisë së arsimit parauniversitar, nga nevoja për një fokus më të qartë në ngritjen e rezultateve të nxënies dhe nga nevoja për përmirësim të monitorimit dhe vlerësimit të punës së institucioneve arsimore, përmes vendosjes së një mekanizmi të përgjegjshmërisë dhe llogaridhënies në institucionet arsimore. Sistemi i sigurimit të cilësisë “përfshin të integruara të gjithë politikat, procedurat rregullat kriteret, mjetet dhe instrumentet e mekanizmat e verifikimit që të gjitha së bashku sigurojnë dhe përmirësojnë cilësinë e kërkuar nga një institucion shkollor” (EU, 2015).

Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI), në vitet e fundit ka zhvilluar një numër të politikave arsimore që lidhen me sigurimin e cilësisë në parauniversitar, të cilat kanë në fokus përkrahjen e nxënësve në zotërimin e kompetencave kryesore të përvijuara me kurrikulën e re. Disa nga politikat arsimore të lidhura me sigurimin e cilësisë në arsimin parauniversitar janë si në vijim:

- Strategjia për sigurimin e cilësisë (2016-2020), e integruar edhe në PSAK 2017-2021;
- Pako e dokumenteve që lidhen me performancën e shkollës – Korniza për sigurim të cilësisë së performancës së shkollës, Instrumenti i vlerësimit të performancës së shkollës, Udhëzuesit për vlerësim të brendshëm dhe të jashtëm, Udhëzuesi për sigurim të cilësisë në shkolla, Udhëzuesi për Aktivitetet profesionale, etj.
- Udhëzimet administrative të veçanta, si UA për Sigurim të cilësisë, UA për vlerësimin e performancës së shkollës, UA për Planifikimin zhvillimor, UA për Aktivitetet profesionale, etj.
- Vendosjen e mekanizmave të veçantë në nivel të institucioneve arsimore për sigurim të cilësisë, në Nivel qendror – Në nivel komunë – Në nivel shkolle.
- Ligji për Inspektoratin e Arsimit, etj.

Strategjia për Sigurim të Cilësisë në Arsimin Parauniversitar në Kosovë 2016-2020, ka për qëllim të prezantojë një sistem të plotë të sigurimit të cilësisë në nën sektorin e Arsimit Parauniversitar të Kosovës, për të kontribuar në përmirësimin e shërbimeve arsimore dhe rezultateve të arsimit. Strategjia ka identifikuar katër objektiva strategjike:

- Ndërtimi i mekanizmave efektivë për sigurimin e cilësisë;
- Avancimi i planifikimit zhvillimor në nivel shkolle dhe komune;
- Ngritja e kapaciteteve për sigurimin e cilësisë në të gjitha nivelet;
- Ngritja e vetëdijes së akterëve për sigurimin e cilësisë

Në anën tjetër, dokumentet tjera dhe udhëzuesit përkatës e bëjnë të zbatueshme dokumentin e strategjisë dhe përcaktojnë rolet dhe përgjegjësitë institucionale në proceset që lidhen me sigurimin e cilësisë. Kështu, me politikat e reja arsimore në Kosovë, sigurimi i cilësisë është përgjegjësi e përbashkët e tri subjekteve të ndryshme të arsimit:

- Ministrisë së Arsimit, e cila përfaqësohet nga Inspektorati i arsimit i cili është mekanizmi i nivelit qendror për sigurim të cilësisë,
- Drejtorive Komunale të Arsimit, të cilat menaxhojnë shkollat dhe janë përgjegjës ndaj komunitetit përkatës, dhe
- Shkollave si ofruese të shërbimeve të drejtpërdrejta.

Korniza për sigurim të cilësisë së performancës së shkollës është dokumenti që krijon ndërlidhjen e punës së përbashkët në mes të Shkollës – DKA – MASHTI/ Inspektoratit të arsimit

Korniza parasheh pesë fusha të cilësisë së performancës së shkollës, respektivisht pesë shtylla të veprimtarisë së shkollës, të cilat janë referenca kryesore organizative për menaxhim të shkollës, (vet) vlerësim, planifikim, intervenim përmirësues dhe avancim të performancës së shkollës në Kosovë. Këto pesë fusha janë:

- a. Menaxhimi dhe qeverisja,
- b. Kultura dhe mjedisi
- c. Mësimdhënia dhe nxënia
- d. Zhvillimi profesional i mësimdhënësve, dhe
- e. Performanca e nxënësve.

Pritshmëritë e përcaktuara për shkollën, kriteret e cilësisë dhe treguesit e performancës së shkollës, janë pritshmëri të cilat duhet të jenë pika referimi edhe për mbështetjen e shkollave nga DKA, si mekanizëm i autoriteteve komunal. Ideja e përgjithshme është se DKA-të duhet të mbështesin shkollat në të gjitha proceset zhvillimore – në menaxhim (vet) vlerësim, planifikim, intervenim përmirësues dhe avancim të performancës.

Secila fushë e cilësisë ka nga pesë kritere. Këto kritere burojnë nga pesë parimet e kurrikulës duke vënë në dukje ndikimin e secilit parim në secilën fushë të veprimtarisë së shkollës. Ndërlidhja e tyre ilustron në shtojcën nr.3 të këtij moduli të trajnimit.

Pritshmëritë e Kornizës për sigurim të cilësisë së performancës së shkollës në Kosovë për adresimin e dhunës në shkollë, braktisjes së shkollimit dhe mosregjistrimit

Për të siguruar mbështetje shkollave në zbatimin e protokollit për parandalim të dhunës në shkollë,

për parandalim dhe reagim ndaj braktisjes dhe mosregjistrimit, KSC dhe EPRBM në nivel komune, fillimisht duhet ta kuptojnë qasjen ndaj vlerësimit të performancës së shkollës dhe ndikimin e saj në punën e përgjithshme të shkollës dhe kërkesat themelore që lidhen me mosregjistrimin dhe braktisjen e shkollimit. Për këtë qëllim, fillimisht duhet të analizohen me shumë kujdes:

- Korniza për sigurim të cilësisë së performancës së shkollës dhe funksioni e saj në procesin e vlerësimit të jashtëm;
- Aspektet kryesore të vlerësimit (fushat cilësisë, kriteret e cilësisë⁵ dhe treguesit e performancës⁶);
- Parimet dhe karakteristikat e vlerësimit të jashtëm
- Treguesit e performancës në fushën e cilësisë: **Kultura dhe mjedisi shkollor.**

Pritëshmeritë e shkollës për mbrojtje të fëmijës, parandalimin e dhunës, mosregjistrimit dhe braktisjes së shkollës, të përcaktuara në kuadër të fushës së cilësisë **Kultura dhe mjedisi shkollor.**

Për të bërë përgatitjet e duhura dhe për të siguruar proces cilësor të mbështetjes për shkollat në zbatimin e platformës për parandalim dhe reagim ndaj braktisjes dhe mosregjistrimit, KSC dhe EPRBM në nivel komune:

- t'i kenë të qarta funksionet dhe detyrat që kanë;
- t'i kenë të qarta pritëshmeritë e reja për shkollën;
- të jenë të njoftuar me platformën për parandalim dhe reagim ndaj braktisjes dhe mosregjistrimit;
- të jenë të njoftuar me rolin, detyrat dhe përgjegjësitë e EPRBM në nivel shkolle, si dhe me masat që janë ndërmarrë për zbatimin e platformës për parandalim dhe reagim ndaj braktisjes dhe mosregjistrimit;

⁵ Kriteret e cilësisë burojnë nga parimet e kornizës kurrikulare të Arsimit Parauniversitar. Ato janë nën-ndarje të fushave të cilësisë.

⁶ Treguesit e performancës janë deklarata afirmative të performancës të cilët shërbejnë si reference për vlerësimin e performancës së shkollës.

- të njihen dhe të kenë të kuptuar të përbashkët për konceptet kryesore dhe faktorët e rrezikut për mosregjistrimin, mosvijim dhe braktisje të shkollimit.

Në fushën e cilësisë: *Kultura dhe mjedisi shkollor*, në dy kriteret e cilësisë, përkatësisht në pesë tregues të performancës së shkollës në kuadër të këtyre dy kriterëve të cilësisë, në mënyrë të drejtpërdrejtë adresohen aspektet që lidhen me parandalimin e dhunës në shkollë:

2.1.3. Nxënësit janë të mbrojtur nga lëndimet dhe dhuna/presioni emocional.

2.5.1. Shkolla ka mekanizma efektiv për t'u marrë me rastet e dhunës në shkollë dhe rastet e aksidenteve dhe fatkeqësive elementare.

2.5.3. Shkolla ka standarde të sjelljes, kujdesit dhe mirëqenies, të hartuara në bashkëpunim me organet shkollore, me prindër dhe komunitet.

2.5.4 Gjithë personeli i shkollës është në dijeni për të drejtat dhe detyrimet e përcaktuara me standardet e sjelljes, kujdesit dhe mirëqenies.

2.5.5 Pakoja e rregulloreve të shkollës është në funksion të parandalimit të abuzimeve, ekseseve dhe shkeljeve të gjitha llojeve.

Ndërsa në kriterin e cilësisë 2.2. të kësaj fushe: **Shkolla siguron për të gjithë nxënësit mundësi të barabarta për zotërim e kompetencave**, janë përcaktuar tre (3) tregues të performancës, të cilët shërbejnë si pika referuese bazë për të mbikëqyrë zbatimin e platformës për PRBM. Këta tregues të performancës janë si në vijim:

2.2.2 Ekipi për Parandalim dhe Reagim ndaj mosregjistrimit dhe braktisjes (EPMRB) është funksional dhe ka procedura të qarta për identifikimin e barrierave të cilat mund të pengojnë qasjen, vijueshmërinë dhe arritjet e nxënësve në shkollë.

2.2.3 Shkolla ka krijuar rrjete të bashkëpunimit me ofrues të jashtëm të shërbimeve sociale, shëndetësore e ekonomike për eliminimin e barrierave, të cilat mund të pengojnë qasjen, vijueshmërinë dhe arritjet e nxënësve në shkollë.

2.2.6 Niveli i braktisjes së shkollës nga nxënësit është shumë i ulët.

Vlerësimi i performancës së shkollës

Sistemi i vlerësimit të performancës së shkollës në Kosovë përbëhet

nga vlerësimi i brendshëm (vetëvlerësimi i shkollës) dhe vlerësimi i jashtëm

Dokumenti i Kornizës për sigurimin e cilësisë së performancës së shkollës në Kosovë, është referencë kryesore për sistemin e sigurimit të cilësisë në arsimin parauniversitar dhe standardizimin e procesit të vlerësimit të performancës së shkollës, planifikimit zhvillimor të shkollës (PZHSH) dhe planit vjetor të veprimit (MASHT & IPK, 2016).

Ndërsa, parimet dhe procedurat për vlerësimin e performancës së shkollës si dhe bartësit kryesorë të këtij procesi janë përcaktuar me Udhëzimin Administrativ (UA nr. 04/2017) për Vlerësimin e Performancës së institucioneve arsimore në arsimin parauniversitar. Sipas Ligjit për Inspektoratin e Arsimit (2018), Inspektorati i Arsimit është autoriteti qendror për sigurimin e cilësisë në arsimin parauniversitar, rrjedhimisht edhe për vlerësimin e jashtëm të performancës së shkollës.

Qasja e sistemit për vlerësimin e performancës së shkollës (VPSH) në Kosovë është zhvillimore, duke shërbyer për planifikimin zhvillimor të shkollës dhe për monitorimin e zbatimit të tij nga shkolla dhe nga autoritetet arsimore. Njëkohësisht, sistemi për VPSH shërben edhe për përcjelljen, monitorimin dhe mbikëqyrjen e cilësisë së menaxhimit dhe shërbimeve arsimore të shkollës (MASHT & IPK, 2016).

Prandaj, kur flasim për sistemin e vlerësimit të performancës së shkollës në Kosovë, i referohemi

- Vlerësimit të brendshëm i shkollës / vetëvlerësimit të shkollës
- Planifikimit zhvillimor i shkollës
- Plani vjetor i veprimit – planit të përmirësimit
- Vlerësimit të jashtëm i shkollës
- Periudhës së zbatimit të vetëvlerësimit, vlerësimit të jashtëm dhe planifikimit zhvillimor të shkollës



Parimet kryesore të kryesore të vlerësimit të performancës së shkollës, si për vlerësim të brendshëm ashtu edhe për vlerësim të jashtëm janë

- Pjesëmarrja
- Transparenca
- Objektiviteti
- Saktësia

Roli DKA në procesin e vlerësimit të performancës së shkollës është dinamik në kuadër të rolit që ka për sigurimin e cilësisë së arsimit në nivel komune. Në radhë të parë roli i DKA në këtë proces është mbështetës për ngritjen e kapaciteteve të brendshme për proceset për sigurim të cilësisë në shkolla dhe për realizimin e vlerësimit të brendshëm dhe vlerësimit të jashtëm, si dhe intervenues në përmirësimin dhe avancimin e shërbimeve arsimore në nivel të komunës.

Roli i DKA-ve në mbështetjen e shkollave për sigurimin e cilësisë

Definimi i rolit të DKA-ve në Sigurimin e cilësisë dhe ngritja e strukturave përkatëse për Sigurim të cilësisë në DKA, është një nga masat e përcaktuara dokumentin e Strategjisë për sigurimin e cilësisë (2016-2020, e cila është zbërthyer në UA nr. 24/2016 për Sigurim të Cilësisë në Arsimin Parauniversitar. Sipas këtij UA, procesi i sigurimit të cilësisë në shkollë mbështetet dhe monitorohet nga DKA përmes një procesi të planifikimit gjithëpërfshirës, ku planet e zhvillimit të arsimit komunal pasqyrojnë/adresojnë nevojat dhe prioritetet e shkollës, prioritetet komunale dhe kombëtare të zhvillimit të arsimit.

DKA për ta përmbushur rolin e saj në sigurimin e cilësisë, në radhë të parë obligohet të emërojë një zyrtar i cili do të jetë përgjegjës për sigurim të cilësisë së arsimit në nivel të komunës. Pra, koordinatori i cilësisë në DKA është zyrtar i DKA-së dhe emërohet nga Drejtori i DKA-së. Është person përgjegjës për koordinimin e cilësisë në DKA. Roli i tij në këtë angazhim orientohet në detyrat në vijim

Detyrat e Koordinatorit për SC në nivel komune	Çka pritet nga KC në nivel komunal?
Koordinon punën e koordinatorëve të shkollës	<ul style="list-style-type: none"> ► Njohja e kuadrit ligjor dhe politikave e programeve për sigurimin e cilësisë në arsimin parauniversitar; ► Njohja dhe familjarizimi me detyra dhe përgjegjësitë e KSC në nivel qendror, në nivel komune dhe në shkolla; ► Informimi dhe sensibilizimi i akterëve kryesorë në shkollat e komunës lidhur me pritëshmeritë dhe rolin e shkollës në SC dhe vendosjen e KC të cilësisë së shkollës; ► Përkrahja e shkollave në funksionalizimi e KSC ► Vendosja e procedurave të përfshirjes së KSC së shkollave në vendimmarrje për proceset e sigurimit të cilësisë në nivel komune; ► Vendosja e mekanizmave efektiv të komunikimit dhe konsultimit të vazhdueshëm me KSC në shkollë;
Të paktën një herë në vit, viziton shkollat për të mbështetur dhe monitoruar zhvillimin e cilësisë në shkollë	<ul style="list-style-type: none"> ► Realizimi i një analize të kontekstit të përgjithshëm të shkollave për qasjen dhe progresin e arritur në zhvillimin e cilësisë në shkollë; ► Hartimi i planit të veprimit dhe koordinimi me KSC në shkolla për vizita në shkolla me qëllim mbështetjen e KSC dhe për të monitoruar zhvillimin e cilësisë në shkollë ► Realizimi i vizitave në shkolla sipas planit vjetor të veprimit; ► Pjesëmarrja në proceset zhvillimore të shkollave; ► Mbështetja e vazhdueshme e KSC në shkolla në proceset që lidhen me zhvillimin e cilësisë në shkollë
Raporton te DKA dhe MASHTI mbi gjetjet e monitorimit dhe mbështetë proceset e zhvillimit të cilësisë në shkollë	<ul style="list-style-type: none"> ► Vendosja e procedurave të brendshme për intervalet kohore të raportimit në DKA nga KSC në shkolla; ► Informimi i KSC në shkolla lidhur me funksionin e raporteve ► Raportimi në DKA dhe MASHTI sipas procedurave dhe intervaleve kohore të përcaktuara nga niveli lokal/DKA dhe niveli qendror/MASHTI
Ofron analiza përmbledhëse të gjetjeve dhe rekomandimeve për drejtor të shkollave dhe DKA	<ul style="list-style-type: none"> ► Analizimi i raporteve të shkollave nga perspektiva e efikasitetit të funksionimit të KSC dhe ndikimit të proceseve që zhvillohen në shkolla në ngritjen e cilësisë; ► Identifikimi i arritjeve, zhvillimeve, sfidave, problemeve, mundësive dhe nevojave për shkollat ► Përgatitja e rekomandimeve të veçanta për shkollat dhe për DKA
Kontribuon në procesin e hartimit të planit zhvillimor të arsimit në komunë duke siguruar ndërlidhjen me planet zhvillimore të shkollave	<ul style="list-style-type: none"> ► Njohja e proceseve të planifikimit zhvillimor të arsimit në komunë; ► Mbështetja e shkollave në procesin e planifikimit zhvillimor, me pjesëmarrje në aktivitete të planifikimit, mentorim dhe me informata kthyesë nga analiza e planeve zhvillimore të shkollave dhe planeve vjetore të veprimit; ► Pjesëmarrja aktive në procesin e hartimit të planit zhvillimor të arsimit në komunë duke siguruar ndërlidhjen me planet zhvillimore të shkollave; ► Informimi i shkollave për përfshirjen e prioriteteve të tyre në planin zhvillimor të arsimit në komunë; ► Ofrimi i mbështetjes shkollave në realizimin e prioriteteve zhvillimore;
Bashkëpunon me koordinatore të cilësisë të drejtorive tjera komunale	<ul style="list-style-type: none"> ► Njohja e programeve që ofrojnë mundësi për zhvillim të kapaciteteve për sistemin e sigurimit të cilësisë; ► Pjesëmarrja aktive në rrjetin e bashkëpunimit me koordinatore të cilësisë të drejtorive tjera komunale; ► Ndarja përvojave të avancuara me KSC së shkollave nga mësimet me KSC në nivel komune;
Bashkëpunon dhe bashkërendon aktivitetet me koordinatorin e cilësisë në MASHTI	<ul style="list-style-type: none"> ► Informimi i vazhdueshëm me kuadrin e politikave dhe planeve për sigurim të cilësisë; ► Bashkërendimi i aktiviteteve me koordinatorin e cilësisë në MASHTI për prioritetet zhvillimore të arsimit në nivel komune, ngritjen e kapaciteteve të KSC në shkolla; ► Ndarja e informacioneve me KSC së shkollave nga takimet, iniciativat dhe aktivitetet e bashkërendimit me KSC në MASHTI

Mbi këtë bazë,

ndarja e funksioneve ndërmjet nivelit qendror e komunal si dhe shkollave bëhet më e qartë, tejkalohen momentet kur shkollat gjejnë zbrazëti ndërmjet përgjegjësiqe qendrore dhe komunale për sigurim të cilësisë dhe kërkojnë informim ose mbështetje që në fazën e parë të vendosjes së këtij mekanizmi, përtej autoriteteve komunale për procese të cilat janë nën përgjegjësiqe të KSC në nivel komune.

KSC në nivel komune për të ushtruar rolin që ka në sigurimin e cilësisë në nivel komune dhe në mbështetjen e shkollave në këtë proces, duhet t'i kushtojë vëmendje dhe kujdes ngritjes së kapaciteteve personale dhe ngritjes së kapaciteteve të KSC në shkolla.

Duke pasur parasysh mungesën e stafit dhe nevojat që kanë DKA për të përmbushur rolin e tyre në sigurimin e cilësisë,

DKA-të inkurajohen që përveç funksionalizimit të pozitës së KSC në nivel komune, të ngrenë edhe grupe profesionale në nivel komunal për të mbështetur shkollat në proces për sigurim të cilësisë, të cilat duhet të koordinohen nga KSC në nivel komune.

Roli i DKA në planifikimin zhvillimor të institucioneve arsimore

MASHTI në kuadër të strategjisë për sigurim të cilësisë në arsimin parauniversitar në Kosovë (MASHT, 2016), vendosi objektiv të veçantë: Avancimin e planifikimit zhvillimor në nivel shkolle dhe komune. Masat e vendosura në kuadër të këtij objekti lidhen me :

- Rishikimin e procedurave dhe instrumenteve për planifikim zhvillimor

- Monitorimin e zbatimit të planeve zhvillimore të shkollave
- Harmonizimin e planeve komunale me planet shkollore sipas fushave të cilësisë, dhe
- Nxitjen e shkëmbimit të praktikave më të mira

Të gjitha këto masa ndërlidhen me rolin dhe detyrat e KSC në nivel komunal, në mënyrë të veçantë me detyrën nr. 5 të përshkruar më sipër: Kontribuon në procesin e hartimit të planit zhvillimor të arsimit në komunë duke siguruar ndërlidhjen me planet zhvillimore të shkollave. Orientim i njëjtë pasqyrohet edhe në UA për PZSHS dhe Planin e zhvillimit të arsimit në nivel komunal (UA 23/2016). Ku sipas këtij UA (neni 11), secila komunë përgatit planin e saj zhvillimor të arsimit bazuar në analizën e situatës aktuale të arsimit në komunën përkatëse dhe planeve zhvillimore të institucioneve/shkollave në nivel të komunës.

Për ta siguruar ndërlidhjen e planit zhvillimor të arsimit në komunë me planet zhvillimore të shkollave në nivel të komunës, KSC në nivel komunal, duhet t'iu referohet përcaktimeve në UA për sigurim të cilësisë në arsimin parauniversitar (2016), nenit 5 të këtij UA lidhur me temat me interes. Sipas përcaktimeve në këtë UA:

- PZSHS, përkatësisht cikli i planifikimit për zhvillim të shkollës, përfshinë dy tema kryesore të ndërlidhura me zhvillim e cilësisë në shkollë.
- Përzgjedhja e temave dhe aktiviteteve për sigurim të cilësisë në shkollë bazohen në fushat e cilësisë të përcaktuara në UA për Planin Zhvillimor të Shkollës të aprovuar nga MASHT.
- MASHT përcakton tema me interes shtetëror bazuar në prioritete aktuale për reformën arsimore në vend.
- Tema me interes për shkollën përcaktohet në bazë rezultateve nga vlerësimi i performancës së shkollës dhe prioriteteve të komunës.
- Temat vjetore mund të përsëriten varësisht nga nevojat dhe interesat shtetërore dhe ato lokale.

- Temat vjetore, ato shtetërore apo në nivel shkolle, pavarësisht kohëzgjatjes, duhet të kontribuojnë në avancimin e të gjitha fushave të cilësisë së shkollës.

Për të udhëhequr punën me shkollat në harmonizimin e planeve komunale me planet shkollore sipas fushave të cilësisë, përveç informatave të mësipërme, ju duhet të njihini të gjithë hapat e punës që zhvillohen në kuadër të këtij procesi, të cilët janë të përshkruar në manualët dhe udhëzuesit për PZSH.

Siç është përshkruar në pjesën më sipër, lidhur me detyrat e KC për planifikimin zhvillimor, pritëshmeritë nga KC në nivel komunal janë si në vijim:

- Njohja e proceseve të planifikimit zhvillimor të arsimit në komunë;
- Mbështetja e shkollave në procesin e planifikimit zhvillimor, me pjesëmarrje në aktivitete të planifikimit, mentorim dhe me informata kthyes nga analiza e planeve zhvillimore të shkollave dhe planeve vjetore të veprimtimit;
- Pjesëmarrja aktive në procesin e hartimit të planit zhvillimor të arsimit në komunë duke siguruar ndër lidhjen me planet zhvillimore të shkollave;
- Informimi i shkollave për përfshirjen e prioriteteve të tyre në planin zhvillimor të arsimit në komunë;
- Ofrimi i mbështetjes shkollave në realizimin e prioriteteve zhvillimore;

3.4. Roli i DKA-ve në krijimin e kushteve për vijueshmëri, qasje të fëmijëve/nxënësve në mësim dhe mbrojtje të fëmijës

Komunat duke u bazuar në kuadrin ligjor dhe strategjitë në arsim, kanë kompetenca për ofrimin e arsimit parashkollor, fillor dhe të mesëm, menaxhimin me personelin mësimdhënës dhe jo mësimdhënës, menaxhimin e administrimit të institucioneve arsimore parauniversitare në nivel komune dhe trajnimin e mësimdhënësve administratorëve të arsimit.

Institucionet komunale gjithashtu kanë detyrime dhe përgjegjësi për mbrojtjen e fëmijës, gjegjësisht krijimin e kushteve për vijueshmëri, qasje të fëmijëve/nxënësve në mësim, parandalimin dhe reagimin përmes mekanizmave të saj ndaj dhunës në shkollë, mosregjistrimit të shkollimit, braktisjes, etj. Detyrimet dhe përgjegjësitë e komunës në këtë fushë shtrihen nën sektorët e komunës dhe tek mekanizmat e brendshëm siç janë DKA dhe EPRBM.

Në pjesën e këtij moduli (3.4.) për Kornizën e politikave arsimore për mbrojtjen e fëmijëve në Kosovë, janë dhënë orientime përmbledhëse lidhur me dokumentet që referojnë rolin e institucioneve arsimore dhe institucioneve tjera për aspekte të veçanta të mbrojtjes së fëmijës dhe burimet ku mund të sigurohen për konsultim dhe referim në këto dokumente, përfshirë:

- Planet strategjike;
- Protokollin për parandalimin dhe referimin e dhunës në institucionet e arsimit parauniversitar
- Udhëzimi Administrativ për EPRBM
- Moduli për Sistemin e Paralajmërimit të Hershëm (SPH) të braktisjes në SMIA;
- Doracakët për EPRBM;
- Udhëzimi Administrativ për mbrojtjen e fëmijëve në internet
- Pakoja e udhëzuesve për mbrojtjen e fëmijëve në internet

Në pjesën në vijim, në kuadër të kësaj teme do ofrojmë orientime dhe udhëzime për rolin e DKA-ve dhe përmbushjen e këtij roli në krijimin e kushteve për vijueshmëri, qasje të fëmijëve/nxënësve në mësim dhe mbrojtje të fëmijës, duke u fokusuar në:

- Rolin e EPRBM-ve të komunave në parandalimin, reagimin dhe trajtimin adekuat të problemit të braktisjes dhe mos-regjistrimit në arsimin e obliguar.
- Kapacitetet e DKA-s në identifikimin dhe eliminimin e barrierave të qasjes në arsim, adresimin e dhunës, braktisjes dhe mos-regjistrimit
- Strategjitë dhe mjetet për EPRBM-të komunale
- Plani i veprimit për braktisje dhe reagim ndaj braktisjes dhe mosregjistrimit të fëmijëve në shkolla

Roli i EPRBM-ve të komunave në parandalimin, reagimin dhe trajtimin adekuat të problemit të braktisjes dhe mos-regjistrimit në arsimin e obliguar

Gjëja e parë e rekomanduar në drejtim të funksionalizimit të EPRBM-ve është njohja dhe të kuptuarit e përbashkët të rolit të EPRBM-ve, të parimeve mbështetëse në punën e tyre dhe të detyrave, në rastin konkret të detyrave të EPRBM-ve në nivel komune.

Roli i të gjitha EPRBM-ve, pra edhe roli i Roli i EPRBM-ve të komunave në parandalimin, reagimin dhe trajtimin adekuat të problemit të braktisjes dhe mos-regjistrimit në arsimin e obliguar, është përcaktuar me Udhëzimin Administrativ përkatës (UA nr. 08/2018). Sipas këtij UA, dy janë rolet kryesore:

- Bashkëpunimi me institucionet përkatëse shtetërore, organizatat joqeveritare, si dhe me të gjitha grupet tjera të interesit për të parandaluar në kohë reale rastet e rrezikut të lartë të braktisjes dhe mosregjistrimit në institucionet arsimore parauniversitare; dhe
- Përdorimi i të gjithë mekanizmave dhe mundësive për të identifikuar, parandaluar,

raportuar, referuar dhe trajtuar me efikasitet predispozitat dhe rastet e braktisjes

Puna e EPRBM-ve, sipas UA përkatës, duhet të bazohet në parimet themelore të instrumenteve ligjore vendore dhe ndërkombëtare që lidhen me sigurimin e të drejtës së arsimit cilësor për të gjithë, si:

- Barazia
- Pjesëmarrja dhe gjithëpërfshirja
- Mosdiskriminimi
- Mbijetesa dhe zhvillimi

Sipas UA përkatës për EPRBM, ekipet në nivel të komunës themelohen nga Drejtoria Komunale e Arsimit, e cila përfaqësohet me dy anëtarë në këto ekipe dhe në përbërje siç është përcaktuar në udhëzim. Pas themelimit, EPRBM në nivel komunal, për përmbushje të rolit të tij në mbështetje të parimeve të cituara më sipër, ka përgjegjësi që:

- Të takohet çdo tre muaj, e sipas nevojës edhe më shpesh, për të shqyrtuar dhe trajtuar të gjitha rastet që referohen nga shkollat;
- Të raporton te drejtori komunal i arsimit, çdo tre muaj dhe sipas nevojës;
- Përmes kryesuesit të EPRBM në nivel komunal, të informojë ekipet shkollore mbi ecurinë e trajtimit të rasteve konkrete;
- Të raportojë tek EPRBM në nivel qendror/ MASHTI.

Në mbështetje të ekipeve komunale për të ushtruar rolin dhe mandatin që kanë në parandalimin, reagimin dhe trajtimin adekuat të problemit të braktisjes dhe mos-regjistrimit në arsimin e obliguar, MASHTI me mbështetje nga UNICEF, në vitin 2014 ka hartuar doracakun për ekipet komunale (i cili është në rishikim dhe plotësim në bazë të zhvillimeve të reja në arsim), i cili ofron:

- udhëzime dhe ide për EPRBM-të e komunave për fitimin e shkathtësive të nevojshme me qëllim të kryerjes së punës së tyre, si dhe
- mjete konkrete për të ndihmuar EPRBM-të e komunave që të ndër marrin veprime të cilat do të kontribuojnë në parandalimin dhe reagimin ndaj braktisjes së shkollës.

Pra, për të përmbushur rolin tuaj në kuadër të EPRBM në nivel komunal, ju duhet veproni sipas rolit, parimeve dhe detyrave të përcaktuara me UA përkatës dhe duhet të shfrytëzoni udhëzimet, idetë dhe mjetet/ instrumentet e punës për të ndërmarrë veprime konkrete të cilat do të kontribuojnë në parandalimin dhe reagimin ndaj braktisjes së shkollës.

Puna e EPRBM-ve komunave në masë të madhe lidhet edhe me dokumentimin e rasteve në modulën e Sistemit të Paralajmërimit të Hershëm (SPH), rasteve të braktisjes së shkollimit, mosregjistrimit në shkollë dhe rasteve në rrezik për të braktisur shkollimin dhe me referimin e rasteve që i takojnë apo lidhen me nivelin komunal. Udhëzimi administrativ për EPRBM (2018), parasheh dispozitat për modulën e veçantë të Sistemit të paralajmërimit të hershem (SPH) në Sistemin për menaxhimin e informatave në arsim (SMIA), i cili:

- a. Gjeneron informacion mbi rastet në rrezik të braktisjes, të cilat i identifikojnë, raportojnë dhe trajtojnë shkollat në përditshmëri.
- b. Ndërlidh informatën nga shkolla, DKA-ja dhe MASHT-i, duke ofruar informacione sasiore e cilësore dhe indikacione për situatën në terren dhe mundësi për orientimin e politikave në të gjitha nivelet: shkollë, DKA dhe MASHT.

- c. korrespondon dhe i kontribuon me informacion edhe modulit e regjistrimit të rasteve të dhunës në shkolla.
- d. Shkollat obligohen që rastet e identifikuar në rrezik të braktisjes t'i regjistrojnë në Sistemin e Paralajmërimit të Hershëm (SPH) dhe t'i mbajnë përgjegjëse institucionet relevante që figurojnë në sistem të referimit dhe trajtimit të rasteve.
- e. Për futjen e të dhënave në SPH, është përgjegjës drejtori i shkollës dhe qasje në sistem mund të kenë personat e autorizuar nga drejtori (anëtarë të EPRBM-së).

- Përmirësimi i dokumentimit në SPH i rasteve të braktisjes së shkollimit, mosregjistrimit në shkollë dhe rasteve në rrezik për të braktisur shkollimin, është rekomandim tjetër për EPRBM komunale. Udhëheqësit e ekipeve komunale, në koordinim të plotë me DKA, sugjerohen që të punojnë me shkollat në informimin e tyre dhe në ngritjen e kapaciteteve për regjistrimin SPH të gjitha rasteve të braktisjes së shkollimit dhe mosregjistrimit në shkollë dhe referimin e rasteve që janë në përgjegjësi dhe mund të bëhen nga shkollat.

Kapacitetet e DKA-s në identifikimin dhe eliminimin e barrierave të qasjes në arsim

Dimensioni i kapaciteteve në DKA për identifikimin dhe eliminimin e barrierave të qasjes në arsim, në masë të madhe lidhet me stafin që kanë DKA-të, përgatitjen dhe përvojën e tyre, funksionimin e mekanizmave të DKA, siç janë edhe EPRBM në nivel komune, por edhe EPRBM në nivel shkolle.

Për të siguruar kapacitete efektive në identifikimin dhe eliminimin e barrierave të qasjes në arsim në nivel të DKA, nevojitet që fillimisht kompletohet ekipi në nivel të komunës, pastaj

- të bëhet një analizë e nevojave të EPRBM për informim dhe për zhvillim të shkathtësive për

identifikimin dhe eliminimin e barrierave të qasjes në arsim⁷, për mbrojtjen e fëmijëve;

- të sigurohen të gjitha dokumentet, protokollet dhe doracakët që lidhen me mbrojtjen e fëmijës, parandalimin e dhunës, punën e EPRBM, etj.;
- të analizohet konteksti i arsimit në nivel të komunës, sfidat, barrierat në arsim, përfshirë barrierat në qasje, cilësinë e arsimit, kushtet ekonomike dhe sociale, dhunën në shkolla, ndikimin e faktorëve familjarë, shkollorë dhe social, etj.
- të mbahen trajnime, aktivitete mentorimi dhe këshillimi me DKA dhe EPRBM, në bazë të planit të punës së EPRBM në nivel komunal.

Identifikimi i barrierave të qasjes në arsim është vetëm një hap drejt adresimit të tyre nga institucionet që kanë role dhe përgjegjësi në këtë fushë. Pa dyshim, roli i institucioneve arsimore në adresimin e punës së fëmijëve është i rëndësishëm së veçantë. Në këtë mes hyjnë edhe Komunitat/DKA, të cilat sipas legjislativës në fuqi, kanë përgjegjësi të veçanta në menaxhimin e arsimit në nivel komunal, krijimin e kushteve për vijueshmëri, qasje të fëmijëve/nxënësve në mësim dhe mbrojtje të fëmijës, koordinimin e masave me mekanizmat tjerë në nivel të komunës dhe MASHTI-it në adresimin e këtyre barrierave, si dhe në mbështetjen e shkollave në procesin e mësimor dhe të zhvillimit të saj.

Procesi i identifikimit dhe eliminimit të barrierave të qasjes në arsim, merr kohë dhe njëkohësisht kërkon kapacitete të brendshme, si në nivel qendror, ashtu edhe në nivel komunal dhe në nivel të shkollës. Për këtë nevojiten analiza të nevojave siç është përshkruar me lartë dhe pastaj nevojiten

te zhvillohen plane të veprimit për zhvillimin e kapaciteteve.

Referuar planit të punës së EPRBM-ve dhe nevojave të tyre, DKA-të sugjerohet që të ofrojnë

- Trajnime për EPRBM në nivel komunal të cilat duhet të fokusohen në identifikimin e fëmijëve jashtë shkollës, trajtimin e rasteve në nivel komunal, si dhe strategjitë në nivelin komunal për parandalim dhe reagim ndaj braktisjes;
- Monitorim, mentorim dhe mbështetje permanente në përkrahjen dhe lehtësimin e zbatimit të planit të veprimit të EPRBM;
- Organizim të takimeve me EPRBM në nivel të shkollave, aktivitete për shkëmbimin e përvojave të mira në mes EPRBM në shkollat e komunës,
- Shkëmbimin e përvojave me EPRBM me komunitet tjerë
- Mbështetje në hartimin e instrumenteve për identifikimin e fëmijëve jashtë shkollës, etj.

Strategjitë dhe mjetet për EPRBM-të komunale

Në doracakun për EPRBM komunale (2014), ofrohen orientime për strategjitë dhe mjetet për EPRBM-të komunale për përmbushjen e rolit të tyre. Sipas doracakut, në bazë të analizës së gjendjes, EPRBM-të komunale, në bashkëpunim të ngushtë me EPRBM-të shkollorë dhe shkollat në të cilat ka mos-regjistrim të fëmijëve ose ekziston rreziku i braktisjes së shkollës, EPRBM komunale hartojnë planin e veprimit, të cilin e harmonizojnë me aktivitetet e caktuara brenda Planeve të

7 Referuar pjesës 3.1 të këtij moduli, kujtoni disa nga barrierat e qasjes në arsim, si:

- Kushtet e vështira ekonomike në familje;
- Mungesa e shërbimeve profesionale në shkolla;
- Distanca e shkollave në vendet rurale (mungesa e transportit të organizuar);
- Mungesa e sigurisë gjatë rrugës në shkollë;
- Dhuna në shkollë;
- Prezenca e lokaleve në afërsi të shkollës;
- Qasja afirmative ndaj punës së fëmijëve dhe mungesa e vetëdijes për efektet negative në shndetin dhe zhvillimin e fëmijës;
- Mungesa e bashkëpunimit të shkollës me institucionet e mirëqenies sociale për trajtimin e rasteve të fëmijëve të përfshirë në punë;
- Angazhimi i pamjaftueshëm i Drejtorive Komunale të Arsimit dhe mekanizmave relevant për adresimin e braktisjes së shkollës dhe punës së fëmijëve;
- Cilësia e Arsimit (kurrikula e shtërgarkuar, metodologjia joadekuate e punës me nxënës, mungesa e mjeteve mësimore dhe infrastrukturës së përshtatshme shkollorë, punë me ndërrime).

Veprimet në nivel të shkollave.

Në planin e veprimit, rekomandohet që të përfshihen strategjitë kryesore të EPRBM komunale për identifikimin dhe referimin e rasteve të braktisjes së shkollimit, mosregjistrimit në shkollë dhe rasteve në rrezik për të braktisur shkollimin, duke përfshirë shtyllat kryesore të intervenimit, si:

- Përfshirja e masave për mbrojtjes së fëmijës, identifikimin dhe eliminimin e barrierave të qasjes në arsim, në të gjitha dokumentet dhe planet dinamike të punës në nivel komunal që lidhen me fëmijët/nxënësit dhe shkollimin e tyre;
- Funkcionalizimi i EPRBM në nivel komune dhe mbështetja e shkollave për funksionalizimin e EPRBM në shkolla;
- Aktivitetet vetëdijësuese - ngritja e bazës së informimit dhe sensibilizimit për identifikimin e rasteve të braktisjes së shkollimit, mosregjistrimit në shkollë dhe rasteve në rrezik për të braktisur shkollimin;
- Ngritja e kapacitetit të EPRBM në nivel komune dhe të shkollave;
- Ngritja e nivelit të komunikimit në mes të EPRBM-ve dhe hisedarëve tjerë në nivel komune
- Dokumentimi në modulën e SPH të rasteve të braktisjes së shkollimit, rasteve në rrezik për të braktisur shkollimin, për t'i referuar pastaj të gjitha rastet në shërbimet përkatëse, nëse një gjë e tillë është nevojshme;
- Ofrimi i shërbimeve të drejtpërdrejta për rastet e braktisjes së shkollimit, mosregjistrimit në shkollë dhe rasteve në rrezik për të braktisur shkollimin;

Plani komunal i veprimit për parandalim të braktisjes dhe reagim ndaj braktisjes dhe mosregjistrimit të fëmijëve në shkolla

Në doracakun për qeverisjen e arsimit në komuna, përshkruhet se është detyrë e DKA-ve që të kujdeset për krijimin e mekanizmave efektive të evidentimit, monitorimit, raportimit,

ndërhyrjes dhe të llogaridhënies për identifikimin, referimin dhe menaxhimin e rasteve të fëmijëve jashtë shkolle, për të parandaluar mungesat e nxënësve dhe braktisjen e shkollës. Këtë orientim për përmbytje të kësaj detyre, duhet të ketë edhe Plani komunal i veprimit për parandalim të braktisjes dhe reagim ndaj braktisjes dhe mosregjistrimit të fëmijëve në shkolla.

Parim bazë për hartimin e planit të veprimit, është përfshirja në procesin e planifikimit e të gjithë akterëve të EPRBM dhe mekanizmave tjerë në nivel komune, në mënyrë që përgjegjësia në zbatim të shpërndahet sipas përgjegjësve të përcaktuar për aktivitetet përkatëse.

Në kuadër të planit të veprimit, EPRBM në nivel të komunës duhet t'i identifikojë intervenimet me prioritet për të siguruar kushtet elementare për fillimin e këtij procesi. Disa nga intervenimet janë diskutuar në pjesën e më sipërme për strategjitë dhe mjetet për EPRBM-të komunale.

Në linjë planin e veprimit për EPRBM komunale, janë dhënë orientime dhe udhëzime në doracakun përkatës (2014), sipas të cilit instrumenti për zhvillimin e Planit Komunal të Veprimit për parandalimin e braktisjes së shkollës dhe të qenit jashtë shkolle, përfshin informatat që duhet të përmbajë analiza e situatës dhe çfarë të dhënash duhet të mblidhen për zhvillimin e analizës së situatës dhe dimensionet që duhet të merren parasysh kur bëhet planifikimi.

Plani i veprimit për parandalim të braktisjes dhe reagim ndaj braktisjes dhe mosregjistrimit të fëmijëve në shkolla është dokument dinamik i punës së EPRBM në nivel komune. Çdo planifikim në arsim dhe përtej arsimit, duhet të bazohet ciklin "planifiko, bëj, kontrollo dhe vepro":

- "planifiko" i referohet planit të veprimit, bazuar në analizën e gjendjes, raportin e vetëvlerësimit;
- "bëj" i referohet zbatimit të planit të masave dhe aktiviteteve, përgjatë kohëzgjatjes së planit të veprimit;
- "kontrollo" i referohet verifikimeve dhe kontroleve që përfshihen për të monitoruar performancën në realizimin e aktiviteteve të planifikuara dhe në arritjen e rezultateve të synuara, dhe

- ▶ “vepro” i referohet informacioneve kthyesë dhe procedurave të ndryshimit e veprimeve të nevojshme për rishikim, në varësi të nevojave dhe mundësive të identifikuar.

Kjo do të thotë se fillimisht duhet të sigurohet përfaqësimi i të gjithë mekanizmave të shkollës në procesin e planifikimit.

Analiza gjithëpërfshirëse e gjendjes së arsimit në nivel të komunës, barrierave të qasjes në arsim dhe e situatës me rastet e braktisjes së shkollimit, mosregjistrimit në shkollë dhe rasteve në rrezik për të braktisur shkollimin, përbën bazën e një planifikimit të mirë organizuar dhe të vendosjes së masave për eliminimin e barrierave të qasjes në arsim dhe të përmirësimit të hapave në referimin e rasteve të braktisjes së shkollimit, mosregjistrimit në shkollë dhe rasteve në rrezik për të braktisur shkollimin. Për një analizë gjithëpërfshirëse në këtë fushë, duhen dhënë përgjigje të duhur tri pyetjeve në vijim:

- ▶ Ku jemi tani?
- ▶ Ku duam të jemi?
- ▶ Si do të arrijmë atje?

Pasi që ekipi planifikues në nivel komune ka qartësuar përgjigjet në këto tri pyetje, ka përfunduar analizën e gjendjes, ka identifikuar barrierat kryesore të qasjes në arsim, situatën reale me problematiken e braktisjes dhe mosregjistrimit të shkollimit, si dhe ka identifikuar mundësitë për eliminimin e të gjitha barrierave të qasjes në arsim, fillon me procesin e planifikimit.

Procesi planifikimit duhet të jap përgjigje konkrete në pyetjet në vijim, përgjigje të cilat integrohen në instrumentin për zhvillimin e planeve komunale të veprimit për fëmijët jashtë shkolle dhe parandalimin e braktisjes së shkollës në Kosovë:

- ▶ Qëllimi dhe objektivat - Cilat janë qëllimet e vendosura, objektivat në eliminimin e të gjitha barrierave të qasjes në arsim?

- ▶ Prioritetet - Cilat janë prioritetet afatshkurtra dhe afatmesme ?
- ▶ Masat që do të ndërmerren – Çfarë duhet të bëhet?
- ▶ Afatet e caktuara - Kur?
- ▶ Përgjegjësit - Kush?
- ▶ Burimet njerëzore dhe financiare - Me çka? Kush mbështet?
- ▶ Treguesit e performancës, dëshmitë dhe dokumentimi - Cilët janë treguesit? Si dhe kur pasqyrohen dëshmitë, si dhe ku raportohet?

Doracakun për EPRBM komunale (2014), ofron informata mbi dimensionet që duhet marrë parasysh kur përgatitet plani i veprimit për parandalim të braktisjes dhe reagim ndaj braktisjes dhe mosregjistrimit të fëmijëve në shkolla. Informacionet e organizuara në kuadër të 16 moduleve, duhet të merren për bazë nga Ekipi në fazën e planifikimit, por edhe gjatë procesit të zbatimit të planit. Modulet mbulojnë temat në vijim⁸:

- ▶ Moduli 1: Identifikimi, monitorimi dhe raportimi i fëmijëve jashtë shkolle ose në rrezik të braktisjes së shkollës;
- ▶ Moduli 2: Regjistrimi i informatave për fëmijët jashtë shkolle dhe nxënësit braktisës;
- ▶ Moduli 3: Përgatitja për regjistrim në klasën e parë;
- ▶ Moduli 4: Sistemi arsimor për ngritjen e vetëdijesimit të komuniteteve romë, ashkali dhe egjiptas;
- ▶ Moduli 5: Dokumentimi dhe regjistrimi;
- ▶ Moduli 6: Fillimi i sigurtë me arsimim në fëmijërinë e hershme;
- ▶ Moduli 7: Mbështetja e plotë për nxënësit në rrezik të braktisjes;
- ▶ Moduli 8: Mbështetja për mësimnxënie për nxënësit në rrezik të braktisjes së shkollës;

⁸ Më gjerësisht për çështjet që mbulojnë modulet, shih Doracakun për EPRBM komunale (2014), https://masht.rks-gov.net/uploads/2015/12/doracak-per-ekipet-komunale-per-parandalim_1.pdf

- Moduli 9: Mosvijimi
- Moduli 10: Çështjet financiare, materiale dhe transporti;
- Moduli 11: Gjithëpërfshirja dhe siguria në komunitet dhe në shkolla;
- Moduli 12: Shërbimet rinore të komunitetit dhe mbështetja;
- Moduli 13: Nga arsimi joformal në atë zyrtar;
- Moduli 14: Mbështetja e shkollave;
- Moduli 15: Grumbullimi i të dhënave dhe monitorimi;
- Moduli 16: Shërbimet për fëmijët e riatdhesuar dhe ata të kthyer

Puna e EPRBM në nivel komune e mbështetur mbi këtë bazë të moduleve,

Është në linjë me rolin që ka EPRBM dhe DKA në krijimin e kushteve për vijueshmëri, qasje të fëmijëve/nxënësve në mësim dhe mbrojtje të fëmijës.

3.5. Monitorimi dhe vlerësimi, mbështetja dhe raportimi për EPRBM

Për përkrahjen e EPRBM-ve në nivel shkolle dhe sigurimin e qëndrueshmërisë së tyre duhet të ndërtohet një praktikë e mirë konsoliduar në nivel komune për monitorimin dhe vlerësimin e procesit të krijimit dhe të funksionimit të mekanizmit të EPRBM.

Procesi i monitorimit duhet të nxjerrë në pas sukseset/arritjet, sfidat, nevojat, mundësitë për të ngritur cilësinë e shërbimeve arsimore, në funksion të sigurimit të qasjes në arsim për të gjithë, ndikimin e mekanizmit të EPRBM si në nivel komunal ashtu edhe në nivel shkolle, si dhe mësimet e nxjerra të cilat duhet të ndahen me akterët relevantë për ta përshtatur dhe për ta

përmirësuar procesin, aty ku është e nevojshme.

Përgatitjet për monitorim - Çfarë duhet marrë parasysh gjatë procesit përgatitor të monitorimit? Procesi i monitorimit dhe vlerësimit të krijimit dhe të funksionimit të mekanizmit të EPRBM duhet të mbajë në konsideratë:

- Kontekstin e shkollave dhe kulturën e komunitetit të shkollës
- Përfshirjen e shoqërisë civile
- Planin e punës së EPRBM në nivel shkolle
- Përvojën paraprake të shkollës dhe punës së EPRBM në menaxhimin e rasteve
- Mundësitë e shkëmbimit efektiv të informacionit
- Të dhënat e raportuara modulin e Sistemit të Paralajmërimit të Hershëm të braktisjes

Monitorimi - Vizitat në shkolla dhe takimet e drejtpërdrejta me EPRBM shkollore, janë mënyra më efikase për të monitoruar efektshmërinë e punës së EPRBM, për të mbikëqyrur procesin e menaxhimit të rasteve. Vizitat në shkolla duhet të bëhen për mbledhjen e informatave për:

- Funksionimin e EPRBM në nivel shkolle;
- Realizimin e planit të shkollës për parandalimin dhe reagimin ndaj braktisjes së shkollës;
- Identifikimin e fëmijëve jashtë shkollave;
- Strategjitë për parandalimin e braktisjes së shkollës në nivel të shkollës;
- Punën që bëjnë EPRBM në nivel shkolle në raportim e rasteve në modulin e Sistemit të Paralajmërimit të Hershëm të braktisjes;

Në rrethanat aktuale, kur sistemet arsimore dhe shoqëria ballafaqohet me pandeminë COVID 19, janë të nevojshme modalitetet dhe alternativat ndryshe për të monitoruar punën e institucioneve arsimore/shkollave, përtej vizitave të drejtpërdrejta në shkolla, si takime online dhe komunikimet e rregullta përmes programeve

aplikative që mundësojnë mbledhjen dhe shqyrtimin e informacioneve dhe rasteve të menaxhuara apo rasteve për të cilat nevojitet përkrahje nga autoritetet komunale dhe mekanizmat e saj.

Për mbledhjen e të dhënave nga vizitat në shkolla dhe takimet e drejtpërdrejta me EPRBM shkollore, takimet me drejtues të shkollës, mësime të ndërmjetshme, prindër, etj., si dhe nga takimet online, apo modalitet tjera të punës, sugjerohet që përgatiten dhe përdoren instrumente standarde që mundësojnë nxjerrjen e raporteve përmbledhëse në nivel të komunës, lidhur me indikatorë relevantë për parandalim dhe reagim ndaj dhunës në shkollës, braktisjes dhe mosregjistrimit të shkollimit. Në ndihmë të punës së Inspektoratit të Arsimit dhe të Drejtorive Komunale të Arsimit, janë përgatitur dy instrumente që mund të përdoren për këto qëllime, të cilët janë vendosur në shtojcë të këtij modulit të trajnimit:

- Shtojca 4: *Listë kontrolli për analizën e punës së Ekipeve për Parandalim dhe reagim kundër braktisjes dhe mosregjistrimit;* dhe
- Shtojca 5: *Formulari me listën e pyetjeve sipas indikatorëve relevantë për parandalim dhe reagim ndaj braktisjes dhe mosregjistrimit të shkollës.*

Monitorimi i planit të veprimit të EPRBM në nivel komune - DKA, krahas monitorimit të punës së EPRBM shkollore, bën edhe monitorimin dhe vlerësimin e zbatimit të planit të veprimit të EPRBM në nivel komune, përmes mbledhjes së të dhënave dhe regjistrimit të tyre, analizës së progresit dhe nxjerrjes së orientimeve dhe rekomandimeve për veprimeve përmirësuese. Si bazë për monitorimin e aktiviteteve është plani i aktiviteteve apo masave të planit vjetor të veprimit, në raport me secilin objektiv specifik të planit të veprimit.

Progresi apo vlerësimi për zbatimin e planit të veprimit të EPRBM në nivel komune, rekomandohet të bëhet në tri nivele, sipas udhëzimeve në UA (2016) për planin vjetor të DKA dhe planin vjetor të punës së shkollës, ne:

Niveli i parë përfshin aktivitetet e realizuara me kohë (shënohen me ngjyrë të gjelbër)

Niveli i dytë përfshin aktivitetet që janë vonuar në zbatim (shënohen me ngjyrë të verdhë)

Niveli i tretë përfshin aktivitetet që janë anuluar apo janë në rrezik të anulohen (shënohen me ngjyrë të kuqe).

Kështu, shënimi i vlerësimit të progresit bëhet me përdorimin e ngjyrave të semaforit

Objektivat specifike	Masat/ Aktivitetet	Progresi			Të arriturat	Vështirësitë	Masat shtesë
		A	B	C			
OS1	1.1.						
	1.2.						
	1.3.						
	1.4.						

Raportimi

Monitorimet rekomandohet të shoqërohen me raporte që pasqyrojnë funksionalizimin e EPRBM⁹, progresin në vazhdimësi të planit të EPRBM,

menaxhimit të rasteve. Sugjerohet që në nivel komune të përgatiten raporte 3- mujore dhe raporti vjetor. Raportet duhet të përdoren për:

⁹ Në shtojcën nr. 2 të këtij modulit të trajnimit është dhënë një pjesë nga raporti përmbledhës mbi gjetjet nga monitorimi dhe mentorimi i DKA-ve dhe shkollave, lidhur me funksionimin e EPRBM SH.

- të siguruar që aktivitetet për realizimin e masave të planifikuara dhe arritjen e objektivave për parandalimin dhe reagimin ndaj braktisjes së shkollës janë duke përparuar mirë;
- të shërbyer si një mjet për EPRBM në nivel komune për të nxjerrë në pah rastet e pazgjidhura;
- të marrë vendime për rastet që duhet menaxhuar nga niveli komunal dhe strategjitë që duhet përzgjedhur për trajtim dhe menaxhim efektive të rasteve;
- të raportuar tek EPRBM në nivel qendror/ MASHTI, si dhe për
- të orientuar mbështetjen e EPRBM në nivel shkolle.

Raportet e përgatitura nga monitorimi i EPRBM duhet të dorëzohen në DKA dhe tek EPRBM në nivel qendror/në MASHTI. Raportet duhet të jenë specifike për fushën/at përkatëse që janë monitoruar, p.sh.

- Funkcionimi i EPRBM në nivel komune dhe shkollave të komunës;

- Fëmijët që nuk janë regjistruar në shkollë;
- Fëmijët/nxënësit që janë në rrezik të braktisjes së shkollës;
- Fëmijët/nxënësit që kanë braktisur shkollën;
- Vijueshmëria në shkollë;
- Rezultatet dhe arritjet e shkollave, etj.

Raportet duhet të kenë tregues statistikor të matshëm dhe me mundësi të krahasimit me nga raportet paraprake.

Hapat që duhet ndjekur në grumbullimin e të dhënave për modulën e Sistemit të Paralajmërimit të Hershëm të braktisjes analizën e të dhënave për punën e EPRBM dhe efektshmërinë e tyre, duhet të jenë në linjë me një model orientues si më poshtë

Inicimi dhe mbledhja e të dhënave	Raportimi
MASHTI përmes modulit të Sistemit të Paralajmërimit të Hershëm të Braktisjes dhe EPRBM kërkon mbledhjen e të dhënave nga të gjitha shkollat dhe komunat në këtë fushë	MASHTI pranon raportet e komunave me të dhëna në modulën e paralajmërimit të hershëm, vërteton saktësinë e të dhënave që vijnë nga komunat, e përgatit raportin sipas procedurave të MASHTI-it, gjeneron raporte në shkallë vendi dhe inicion procedurave dhe masa për rishikim eventual të politikave, mbështetje të EPRBM në nivel komune dhe shkolle.
DKA kërkon prej shkollave raportimin e të dhënave në modulën përkatëse dhe në formën si është kërkuar nga MASHTI	DKA sheh përmes SMIA-s statistikave nga raportimet e shkollave, vërteton saktësinë e të dhënave që vijnë nga shkollat, e përgatit raportin dhe dërgon në MASHTI. DKA merr masa në rastet kur informatat janë të pasakta. Gjithashtu DKA, pranon raportet/ dosjet e rasteve të shkollave dhe i adreson ato sipas përgjegjësive që ka dhe në koordinim me institucionet tjera në varësi të rasteve.
Shkolla bën veprime në identifikim të rasteve në rrezik të braktisjes, nis trajtimin e tyre dhe i regjistron/ raporton rastet në modulën e Paralajmërimit të Hershëm të Braktisjes	Shkolla raporton për rastet në takime formale në DKA, por DKA nëpërmjet të sistemit të paralajmërimit të hershëm mund të gjenerojë raporte për shkollat, kurdo që t'i duhen për analizë të gjendjes, raportime dhe ndërmarrje të veprimeve. Në fazën kur shkolla i trajton rastet dhe ndonjë prej tyre del në taborr të përgjegjësive të institucioneve tjera (si QPS, PK, MF, etj.), atëherë ato raste i referon në EPRBM komunale me sugjerimin që të trajtohen nga shërbimet e nevojshme sipas specifikave që i kanë. (Shkolla i shkarkon dhe i printon dosjet e rasteve që duhet të referohen në EPRBM komunale, e i dorëzon atje si kopje fizike)

Krahas raporteve, EPRBM në nivel komunal duhet të zhvillojë/rishikojë planin e veprimit me qëllim të përfshirjes së aktiviteteve të domosdoshme që ndihmojnë në përmirësimin dhe avancimin e punës së EPRBM në nivel shkolle dhe krijimin e kushteve për vijueshmëri, qasje të fëmijëve/nxënësve në mësim dhe mbrojtje të fëmijës.

Mbështetja e vazhdueshme e EPRMB

Mbështetja e EPRBM në nivel komunal, përfshirë EPRBM në nivel të shkollave, duhet të përfshijë trajnime, aktivitete mentorimi dhe këshillimi, rrjetëzim të EPRBM, zhvillim të mjeteve ndihmëse të punës, udhëzues, doracakë, etj. Në linjë me këtë rekomandohet që të përdoret edhe ky modul i trajnimit për DKA.

Dokumentimi i punës së EPRBM

Çdo aktivitet që zhvillohet në kuadër të EPRBM duhet të dokumentohet. Dokumentimi rekomandohet të bëhet në varësi të aktiviteteve dhe formave të realizimit të tyre, si:

- Vendimi për EPRBM;
- Plani i punës së EPRBM;
- Agjenda të takimeve;
- Lista të pjesëmarrjes;
- Raporte të menaxhimit të rasteve;
- Raportet nga futja e të dhënave dhe raportimi i në modulin e Sistemit të paralajmërimit të hershëm për nxënësit në rrezik të braktisjes së shkollës
- Raporte informative dhe raporte përmbledhëse për DKA dhe MASHT;
- Foto, videoincizime, etj.

Formë standarde e raportit nga takimet dhe aktivitetet e realizuara nga EPRBM


Në udhëzues dhe doracakë të ndryshëm për shkollat dhe DKA, janë dhënë orientime e udhëzime të ndryshme për formën e raportimit nga mekanizma përkatës. Po thuajse të gjitha

udhëzimet dhe orientimet e dhëna , janë standarde që janë valide edhe për raportet nga EPRBM. Elementet që duhet të përmbaj një raport i punës së EPRBM janë si në vijim:

- Informatat bazë (Data/ Vendi i takimit/ aktivitetit, përpiluesi/ja e raportit, numri i pjesëmarrësve, etj.)
- Hyrje(qëllimi i takimit/aktivitetit/, rrjedha e punës (kohëzgjatja, pjesëmarrës, aspekte organizative, etj.), tema/t e trajtuara)
- Përmbledhje e raportit të takimit/aktivitetit/ (rezultatet/ produktet, vendimet, mësimet kryesore, vështirësitë dhe sfidat, nevojat/ kërkesat)
- Sugjerime, rekomandime për të ardhmen dhe informacione shtesë (rezultatet që priten të zhvillohen, rekomandimet për përkrahje të mëtejshme, komente dhe informacione shtesë)
- Shtojca (agjenda, foto, lista e pjesëmarrjes)

► 4

Shtojca



Shtojca 1:

Roli i institucioneve arsimore në adresimin e punës së fëmijëve- Përmbledhje e raportit për obligimet e institucioneve arsimore për zbatimin e Udhëzimit Administrativ QRK 05/2013 parandalimin dhe ndalimin e formave rrezikshme të punës së fëmijëve në Kosovë¹⁰

MASHT në fund të vitit 2013 (24.12.2013) ka miratuar raportin përmbledhës lidhur me obligimet e institucioneve arsimore (MASHT, DKA dhe shkollat për zbatimin e Udhëzimit Administrativ QRK 05/2013 parandalimin dhe ndalimin e formave rrezikshme të punës së fëmijëve në Kosovë.

Në këtë raport janë përcaktuar intervenimet në funksion të zbatimit të UA 05/2013, sipas përgjegjësi institucionale. Tabela në vijim pasqyron konkluzionet përmbledhëse të miratuara nga grupi punues.

Institucionet	Intervenimet në funksion të zbatimit të UA 05/2013
MASHT	<p>Sektori i kurrikulave</p> <ul style="list-style-type: none"> ▶ Zbatimi I parimit të gjithëpërfshirjes përmes përkrahjes së shkollave që të sigurojnë plan-programet, orarin mësimor, metodat e mësimdhënies dhe vlerësimi, si dhe komunikimi me nxënës dhe prindër të jenë në ndjeshme edhe ndaj nevojave, interesimeve dhe mundësive të fëmijëve në rrezik për të braktisur shkollën (përfshirë fëmijët që kombinojnë punën dhe shkollën); ▶ Përfshirja e aspekteve të sigurisë në punë (rreziqet e punës në disa sektorë, masat mbrojtëse, menaxhimi i rreziqeve, etj.), informimi për format e ndaluara të punës për personat 15-18 vjeç dhe të drejtat e punëtorëve në kuadër të fushës kurrikulare jeta dhe puna dhe në kuadër të moduleve për zhvillimin e aftësive jetësore; <p>Sektori i teksteve dhe mjeteve mësimore</p> <ul style="list-style-type: none"> ▶ Harmonizimi i teksteve me kërkesat e reja që dalin nga kurrikulat e reja dhe Korniza Kurrikulare e Arsimit Parauniversitar, përfshirë edhe rekomandimet për sektorin e kurrikulave (shih pikat paraprake); <p>Sektori i zhvillimit profesional të mësimdhënësve</p> <ul style="list-style-type: none"> ▶ Zhvillimi i një moduli për përgatitjen e mësimdhënësve në tërheqjen e fëmijëve nga format e rrezikshme të punës dhe parandalimin e përfshirjes së fëmijëve në punë; ▶ Ngritja e kapaciteteve të mësimdhënësve për adresimin e nevojave specifike që i kanë fëmijët në rrezik për të braktisur shkollën (përfshirë fëmijët që kombinojnë punën në shkollë) <p>Sektori i arsimit të përgjithshëm</p> <ul style="list-style-type: none"> ▶ Informimi, mobilizimi, mbikëqyrja dhe përkrahja e DKA-ve dhe shkollave në përmbushjen e obligimeve të tyre për zbatimin e UA 05/2013 (shih listën e përgjegjësive për DKA); <p>Divizioni për komunitete</p> <ul style="list-style-type: none"> ▶ Angazhimi i shtuar për sigurimin e përfshirjes së fëmijëve të komunitetit RAE në shkollim; <p>Divizioni i Arsimit profesional</p> <ul style="list-style-type: none"> ▶ Angazhimi i shtuar që shkollat profesionale t'i përgatisin nxënësit për tregun e punës dhe t'i vetëdijësojnë ata për aspektet e sigurisë në punë dhe të drejtat e punëtorëve;

¹⁰ Raporti nga MASHT, me numër të protokollit 217, datë 14.01.2014.

Institucionet	Intervenimet në funksion të zbatimit të UA 05/2013
DKA	<ul style="list-style-type: none"> ▶ Informimi, mobilizimi, mbikëqyrja dhe përkrahja e shkollave në përmbushjen e obligimeve të tyre për zbatimin e UA 05/2013 (të listuara më poshtë); ▶ Analizë e vazhdueshme e gjendjes (numrit të fëmijëve në punë të identifikuar nga shkollat, shkaqet dhe pasojat e angazhimit të tyre në punë); ▶ Adresimi i aspekteve që janë përgjegjësi e DKA-ve, si p.sh.: <ul style="list-style-type: none"> ▶ Sigurimi I transportit jo vetëm në situatat kur distance është e madhe, por edhe në rastet kur siguria nuk është në nivelin e duhur (mungesa e ndriçimit, rreziku nga qentë e rrugës në vendet rurale, apo tjetër); ▶ Organizimi I shujtave ushqimore në shkollat, qoftë përmes funksionalizimit të kuzhinave shkollore, qoftë përmes kontraktimit të shërbimeve përkatëse: vlerësimi I mundësive që fëmijët në nevojë të jenë të liruara nga pagesa e shujtës; ▶ Përmirësimi I infrastrukturës shkollore; ▶ Sigurimi I mundësive që shkollat të organizojnë mësim plotësues për nxënësit me sukses të dobët; ▶ Sigurimi I mundësive për mësim të përsheptuar për fëmijët të cilët kanë braktisur shkollën për një periudhë më të gjatë; ▶ Ngritja e problemeve të evidentuara (që nuk janë përgjegjësi e DKA-ve dhe Shkollave) tek autoritetet përkatëse komunale për angazhim të shtuar (Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale), Drejtoria për Kulturë Rini dhe Sport; Drejtoria e Bujqësisë, Drejtoria e Inspektoratit, etj.); ▶ Pjesëmarrja aktive dhe ngritja e problemeve të evidentuara në takimet koordinuese me partner (Komunitetet Lokale të Veprimit, Komunitetet Lokale të Sigurisë, Task forcat, etj.) apo në takimet tjera që mund të iniciohen nga vetë DKA-të;
Shkollat	<ul style="list-style-type: none"> ▶ Hapja ndaj komunitetit dhe ndjeshmëri e shtuar ndaj problemeve të komunitetit ku vepron shkolla; ▶ Evidentimi i rasteve të fëmijëve të përfshirë në format e rrezikshme të punës (të listuara në Aneks të UA 05/2013) për nevoja të DKA dhe MASHT; ▶ Planifikimi i mbështetjes së individualizuar edukative për tërheqjen e fëmijëve nga puna; ▶ Referimi i rasteve të fëmijëve të përfshirë në format e rrezikshme të punës (të listuara në Aneks të UA 05/2013) në Qendrën për Punë Sociale për trajtim të mëtejshëm; ▶ Përcjellja e trajtimit të mëtejshëm të rasteve të referuara nga QPS apo partnerët tjerë, përmes informative kthyes nga partnerët ku janë referuar rastet; ▶ Aplikimi pakos edukative për parandalim dhe reagim ndaj braktisjes; ▶ Identifikimi i barrierave të qasjes në arsim në nivel shkolle, planifikimi I intervenimeve në nivel shkolle dhe propozimi i masave në kuadër të planeve zhvillimore për DKA dhe MASHT; ▶ Sensibilizim I nxënësve për problemin dhe inkurajimin e Grupeve për të Drejtat e Fëmijëve për përpilimin e materialeve të ndryshme sensibilizuese, si posterë, broshura dhe fletëpalosje dhe për organizimin e aktiviteteve të ndryshme për përkrahje shoku – shokun; ▶ Këshillimi i prindërve ose kujdestarëve dhe anëtarëve të familjes për rreziqet e aktiviteteve të caktuara punuese dhe efektet e mundshme të këtyre rreziqeve në shëndetin dhe zhvillimin e fëmijëve; ▶ Ngritja e nivelit të bashkëpunimit me ofruesit tjerë të shërbimeve dhe partnerët (policinë, QPS, OJQ, bizneset, etj., që ofrojnë programe edukative dhe që kanë në fokus mbrojtjen e fëmijëve) me qëllim largimin nga puna të fëmijëve që kombinojnë shkollën dhe punën apo/dhe kthimin dhe integrimin e fëmijëve të cilët kanë braktisur shkollën;

Shtojca 2:

Pjesë nga raporti përmbledhës mbi gjetjet nga monitorimi dhe mentorimi i DKA-ve dhe shkollave, lidhur me funksionimin e EPRBMSH¹¹

Raporti është hartuar nga Grupi për Parandalim dhe Reagim ndaj Braktisjes dhe Mosregjistrimit të Shkollës në nivel të MASHT.

Raporti përmbledh anën legjislative dhe operative të punës së MASHT me partnerët e vet si dhe gjetjet nga procesi i monitorimit dhe mentorimit në 21 komuna të Republikës së Kosovës, mbi zbatimin e politikave kundër braktisjes së shkollimit në praktikën e përditshme të shkollave, dhe DKA-ve.

Referuar raportit për monitorimin dhe mentorimin e shkollave dhe DKA-ve, respektivisht i ekipeve për parandalim dhe reagim ndaj braktisjes dhe mosregjistrimit të shkollave (EPRBMSH), në fokus ishin dy objektiva:

- Identifikimi i gjendjes për sa i përket themelimit dhe funksionimit të EPRBMSH, si dhe
- Mbështetja e shkollave dhe DKA-ve në funksionalizimin e këtyre mekanizmave

Kjo qasje kishte për qëllim adresimin e barrierave që e cenojnë gjithëpërfshirjen në arsim, duke ngritur kapacitetet e shkollave në identifikimin, raportimin dhe trajtimin e rasteve në rrezik të braktisjes.

Vlerësimi i mekanizmave dhe i përkushtimit institucional për garantimin e vijueshmërisë së rregullt të shkollimit në arsimin e obliguar dhe si dhe për matjen dhe adresimin e faktorëve të rrezikut që e cenojnë shkollimin e fëmijëve tanë, ishte prioriteti i vendosur nga Grupi për Parandalim dhe Reagim ndaj Braktisjes dhe Mosregjistrimit të Shkollës në nivel të MASHT.

Përmbledhje e gjetjeve në DKA

Duke iu referuar pyetjeve dhe përgjigjeve të pranuar, shoqëruar me faktet e ofruara në terren, raporti tregon se 19 komuna e zbatojnë U.A për themelimin dhe funksionimin e ekipeve dhe rrjedhimisht i kanë themeluar ekipet dhe i përdorin doracakët. Ndërkaq 2 DKA (Dragashi, Prishtina) ende nuk i kanë themeluar ekipet, prandaj qasja e tyre ndaj problemit të braktisjes së shkollimit është vetanake e jo uniforme sipas politikave të përcaktuara dhe sistemit të ndërtuar.

Përmbledhje e gjetjeve në shkolla

Sipas raportit, për dallim nga DKA-të, shkollat qëndronin më mirë për sa i përket themelimit dhe funksionimit të ekipeve për parandalim dhe reagim ndaj braktisjes dhe mosregjistrimit të shkollave. Nga 25 shkollat e monitoruara, 24 e zbatonin U.A . 19/2012, i kishin themeluar ekipet, por jo të gjitha praktikonin doracakët dhe instrumentet për identifikim, trajtim dhe referim të rasteve në rrezik të braktisjes. Si rrjedhojë e kësaj qasjeje, rastet i trajtonin dhe i evidentoni në mënyrën e vet por jo sipas instrumenteve mbi bazën e të cilave krijohen dosjet dhe bartet informacioni në SPH/ SMIA (me disa përjashtime).

¹¹ Më gjerësisht shih: https://ëëë.childrights-ks.org/site/assets/files/1408/raporti_monitorues_mbi_funksionimin_e_epr-bmsh_a5.pdf

Përfundimet

Politikat e parandalimit, identifikimit, trajtimit dhe referimit të rasteve në rrezik të braktisjes dhe ato që e kanë braktisur shkollimin janë mjaft të konsoliduara dhe përmbajtjesore. MASHT me partnerët e vet dhe së fundmi me UNICEF ECMI kanë krijuar një partneritet të mirë në ndërtimin e një sistemi të qëndrueshëm dhe cilësor për trajtimin e kësaj problematike. Mbështetja e deritanishme e shkollave dhe DKA-ve ka rezultuar me situatën që e reflekton raporti. Tashmë DKA-të dhe shkollat e dinë se duhet t'i kenë funksionale këto EPRBMSH, meqë gjatë kësaj periudhe u monitoruar dhe u mbështetën DKA-të dhe disa shkolla.

Që ky sistem të jetësohet siç është pretenduar me U.A dhe instrumente përcjellëse lipset ende të punohet me bazë në shkollë ngase aty është burimi i inicimit të veprimeve, por edhe i evidentimit të problemeve në terren. Natyrisht që DKA –të kanë nevojë të jenë më të fokusuara në nxitjen e bashkëpunimit dhe koordinimit ndërsektorial, ngase karshi rasteve në nevojë, meqë lipsen veprimet dhe shërbimet komunale, të cilat janë të mandatuara me legjislacionin në fuqi.

Përgjithësisht, në të gjitha nivelet duhet të ketë sensibilizim të mirëfilltë për rolet, detyrat dhe përgjegjësitë që i kemi për të siguruar gjithëpërfshirjen në arsim cilësor.

Rekomandimet

Bazuar në situatën dhe nevojat e evidentuara në shkolla dhe DKA, duke pretenduar fuqizimin e mekanizmave për parandalim dhe reagim ndaj braktisjes dhe mosregjistrimit të shkollës, siç e kemi cakun e përcaktuar në Plan Strategjik të Arsimit në Kosovë, po i listojmë rekomandimet si në vijim.

Rekomandimet për shkollë:

- Drejtorët e shkollave të kujdesen për ta mbajtur aktiv dhe funksional Ekipin për Parandalim dhe Reagim ndaj Braktisjes dhe Mosregjistrimit të Shkollës (EPRBMSH);
- Kujdestarët e klasave të ndihmojnë procesin e identifikimit e hershëm të rasteve në rrezik dhe t'i adresojnë ato te EPRBMSH;
- EPRBMSH të dokumentojë veprimet e veta, në formë fizike (procesverbalet e takimeve, dosjet e rasteve) dhe online në SPH, sipas instrumenteve të përcaktuara në doracak;
- EPRBMSH, në koordinim me organet e shkollës, të promovojnë punën e tyre në drejtim të parandalimit dhe reagimit efikas ndaj braktisjes dhe rasteve në rrezik;
- Drejtorët e shkollave të mbajnë aktiv këshillin e prindërve dhe atë të nxënësve për të krijuar partneritetin e duhur në parandalimin dhe reagimin ndaj braktisjes;
- Drejtorët e shkollave të koordinohen me aktivet profesionale, por edhe me partnerë të ndryshëm qeveritarë e joqeveritarë për realizimin e aktiviteteve shtesë (debateve, ligjëratave mbi zhvillimet në arsim dhe barrierat në kontekstin e shkollave).

Rekomandimet për DKA:

- ▶ DKA të sigurojë që EPRBM në nivel komunal të jetë aktiv dhe funksional në shërbim të trajtimit efikas të rasteve që referohen nga shkollat, duke marrë kontributin e duhur të sektorëve të tjerë (të mirëqenies, shëndetësisë, sigurisë etj.), sipas specifikave të rasteve të veçanta;
- ▶ DKA ta integrojë çështjen e parandalimit dhe reagimin ndaj braktisjes në planin e komunës ose të hartojë plan të veçantë veprimi në nivel komune, me qëllim të adresimit të barrierave të qasjes në arsim;
- ▶ DKA të sigurojë buxhet për mbështetjen e aktiviteteve të ekipeve në nivel shkollash;
- ▶ DKA të identifikojë dhe koordinohet me partnerë nga shoqëria civile për të mbështetur zbatimin e politikave në adresim të problemit të braktisjes së shkollimit;
- ▶ DKA të mbajë aktiv Këshillin e Prindërve dhe atë të nxënësve për të krijuar partneritetin e duhur në parandalimin dhe reagimin ndaj braktisjes.
- ▶ Koordinatorët për gjithëpërfshirje të koordinohen me EPRBMSH në adresimin e problemit të braktisjes dhe mosregjistrimit në shkollë.

Rekomandimet për MASHT:

- ▶ MASHT të fuqizojë EPRBMSH në nivel nacional;
- ▶ MASHT, respektivisht shërbimet e inspektoratit të shtojnë vëmendjen në mbikëqyrjen e zbatimit të politikave nacionale kundër braktisjes së shkollimit;
- ▶ MASHT të mbështesë DKA-të dhe shkollat për fuqizimin e EPRBMSH;
- ▶ MASHT të vazhdojë koordinimin me partnerët e vet në trajtimin e problemit të braktisjes dhe fuqizimin e sistemit për paralajmërimin të hershëm të braktisjes.

Shtojca 3:

Korniza e kriterëve të cilësisë së performancës së shkollës

PARIMET E KKAP	FUSHAT E PERFORMANCËS SË SHKOLLËS				
	MENAXHIMI DHE QEVERISJA	KULTURA DHE MJEDISI	MËSIMDHËNIA DHE NXËNIA	ZHVILLIMI PROFESIONAL I MËSIMDHËNËSVE	PERFORMANCA E NXËNËSVE
	KRITERET E VLERËSIMIT				
GJITHËPËRFSHIRJA	1.1 Organet e qeverisjes janë funksionale dhe efektive në përfaqësimin e interesave të komunitetit të shkollës	1.1 Objekti dhe hapësirat përcjellëse të shkollës janë të qasshme, të sigurta, të shëndetshme dhe miqësore	1.1 Shkolla siguron përfshirjen e nxënësve dhe prindërve në aktivitetet mësimore	1.1 Menaxhmenti i shkollës, në planifikimin e ZhPM, përfshin nxënësit, prindërit dhe mësime-dhënësit	1.1 Nxënësit ushtrojnë përgjegjësitë e veta sociale e qytetare në klasë, në shkollë dhe në komunitet
ZHVILLIMI I KOMPETENCAVE	1.2 Shkolla ka në fokus të orientimit strategjik zhvillimin e kompetencave të nxënësve	1.2 Shkolla siguron për të gjithë nxënësit mundësi të barabarta për zotërimin e kompetencave	1.2 Aktivitetet mësimore mundësojnë mbështetje të diferencuar të nxënësve për zotërimin e kompetencave dhe zhvillimin e potencialit	1.2 Praktikant e zhvillimit profesional të mësime-dhënësve janë në funksion të zhvillimit të kompetencave të nxënësve	1.2 Arritshmëria dhe progresi i nxënësve në zotërimin e kompetencave kryesore plotëson pritshmërinë e vendosur me KB
MËSIMDHËNIA DHE NXËNIA E INTEGRUAR	1.3 Organet profesionale të shkollës janë funksionale dhe efektive në jetësimin e mësimin të integruar	1.3 Mjedisit dhe kultura e punës së shkollës janë në funksion të nxënies së integruar dhe jetësimin të kurrikulës	1.3 Përbajtjet dhe aktivitetet mësimore janë në funksion të qasjes së integruar	1.3 Praktikant e zhvillimit profesional të mësime-dhënësve janë në funksion të mësime-dhënies së integruar	1.3 Arritshmëria dhe progresi i nxënësve në zotërimin e rezultateve të përcaktuara për fushat kurrikulare plotëson pritshmërinë e vendosur me KB
AUTONOMIA DHE FLEKSIBILITETI	1.4 Prioritetet e zhvillimit të shkollës pasqyrojnë vizionin e saj, nevojat e nxënësve dhe rezultatet e vetëvlerësimit	1.4 Shkolla ka praktika të konsoliduara të përfshirjes së gjithë komunitetit shkollor në përmirësimin dhe mirëmbajtjen e mjedisit fizik	1.4 Autonomia për planifikimin e kurrikulës me zgjedhje shfrytëzohet në mënyrë efektive	1.4 Shkolla shfrytëzon në mënyrë efektive resurset e saj për aktivitetet e ZhPM	1.4 Nxënësit janë të angazhuar në aktivitete ekstra-kurrikulare
PËRGJEGJËSIA DHE LLOGARIDHËNIA	1.5 Udhëheqja e shkollës udhëheq dhe monitoron zbatimin e PZhSh dhe politikave arsimore	1.5 Shkolla ofron një mjedis të sigurt dhe mundësues për realizim të të nxënies efektive	1.5 Shkolla është e angazhuar për përmirësimin e praktikave të mësime-dhënies dhe të nxënies	1.5 Shkolla mbikëqyrë ndikimin e ZhPM në përmirësimin e cilësisë së mësime-dhënies	1.5 Nxënësit janë të angazhuar në menaxhimin e përparimit vetjak

Shtojca 4:

Listë kontrolli për analizën e punës së Ekipeve për Parandalim dhe reagim kundër braktisjes dhe mosregjistrimit

Komuna:			
Shkolla:			
Funksionimi i EPRBM,	Po	Jo	Komente/ Dëshmitë
Vendimi në nivel shkolle për themelimin e EPRBM është marrë			
Detyrat dhe përgjegjësitë e EPRBM, si dhe dispozitat që krijojnë kushte për punën e ekipit janë përcaktuar në vendim			
Plani i punës është përgatitur nga EPRBM			
Plani i punës përmban aktivitetet kryesore për PRBM, afatet kohore për realizimin e aktiviteteve dhe bartësit e tyre			
Takimet e EPRBM mbahen në baza tre mujore			
Identifikimi i fëmijëve/nxënësve në rrezik të braktisjes së shkollës, braktisës apo që nuk janë regjistruar në shkollë dhe menaxhimi i rasteve	Po	Jo	Komente/ Dëshmitë
Pajtueshmëria e shkollës /EPRBM për listën e treguesve të rrezikut është arritur			
Fletë-identifikimi i nxënësve në rrezik të braktisjes së shkollës është shpërndarë tek kujdestarët e klasave			
Lista e evidencave të nxënësve në rrezik të braktisjes së shkollës është përditësuar			
Menaxherët e rastit për nxënësit e identifikuar në rrezik të braktisjes së shkollës janë caktuar			
Procesi i menaxhimit të rastit ndjek 9 hapat e përcaktuar me udhëzuesin për EPBRM			
Menaxhimi i secilit rast përcillet me fletë-evidentimin individual, planin e menaxhimit të rasteve, dhe për rastet e nevojshme me fletën referuese me arsyetime përcjellëse			
Monitorimi i transferimit nga shkolla bëhet sipas procedurave dhe formularëve zyrtarë të kalimi nga shkolla në shkollë (Me qëllim të mosngatërimit të rasteve të braktisjes me ato të transferit)			
Strategjitë për parandalimin e braktisjes në nivel të shkollës	Po	Jo	Komente/ Dëshmitë
Monitorimi i vijueshmërisë së nxënësve në shkollë bëhet në baza të rregullta			

Njoftimi tek mekanizmat përkatës për mosvijueshmërinë e nxënësit/ve në shkollë bëhet rregullisht			
Procedurat për transferim të nxënësit nga shkolla në një shkollë tjetër dhe anasjelltas janë respektuar			
Nxënësit mentorohen nga mentorët e caktuar nga shkolla			
Nxënësit marrin mbështetje në mësim (mësim plotësues, orë shtesë në gjuhë, orë plotësuese, ndihmë në detyra të shtëpisë etj.)			
Masat të lehtësimit të kalimit ndërmjet klasave dhe niveleve ndërmerren çdo vit shkollor			
Zbatohen strategji të tjera në varësi të rasteve në rrezik të braktisjes së shkollës			
Evidencat e bashkëpunimit dhe rezultateve me ofrues shërbimeve (Qendra për punë sociale, Qendra të mjekësisë familjare, OJQ, etj.) për menaxhimin e rasteve të nxënësve në rrezik të braktisjes së shkollës janë të përditësuara në varësi të rasteve			
Raportimi	Po	Jo	Komente/ Dëshmitë
Raportimi në modulën e Sistemit të Paralajmërimit të Hershëm (SPH) bëhet me kohë dhe sipas procedurave të përcaktuara me këtë modul (SMIA - SPH)			
Raportet e punës së EPRBM përditësohen në çdo periudhë mësimor/ gjysmëvjetorit			
Raportet përmbajnë informacion të mjaftueshëm për punën e EPEBM (<i>për identifikimin e fëmijëve jashtë shkolle, në rrezik për braktisje dhe të atyre që kanë braktisur; menaxhimin e rasteve dhe sukseset e arritura në nivel shkolle dhe me partnerë</i>)			
Raportet s për DKA, MASH dhe IA përmbajnë informacione të mjaftueshme sipas sistemit të paralajmërimit të hershëm dhe sipas kërkesave specifike			

Shtojca 5:

Formulari me listën e pyetjeve sipas indikatorëve relevantë për parandalim dhe reagim ndaj braktisjes dhe mosregjistrimit të shkollës

Lista e pyetjeve sipas indikatorëve relevantë për parandalim dhe reagim ndaj braktisjes					
Shkolla: _____ ; Komuna: _____				Data: _____	Inspektori _____
Nr.	Pyetje/ kërkesa	Pikat kryesore të theksuara	Nënpyetje	Pikat kryesore të theksuara	Komente
1.	Si funksionon EPRBM në shkollën tuaj? Cilat janë arritjet kryesore?		<i>A ka vështirësi? Nëse po, cilat janë ato?</i>		
2.	Sa takime i ka mbajtur ekipi në këtë vit e sa vitin e kaluar?		<i>A ka procesverbale, listë të pjesëmarrjes?</i>		
3.	A e keni në përdorim Doracakun për ekipet shkollore për parandalim dhe reagim ndaj braktisjes dhe mosregjistrimit në arsimin e obliguar. (MASHT, UNICEF, ECMI dhjetor 2014, tashmë i rishikuar sipas U.A 08/2018))		<i>A ka vështirësi në të kuptuarit e udhëzimeve dhe në përdorimin e instrumenteve sipas doracakut?</i>		
4.	Çfarë është e përvoja e juaj në përdorimin e modulit të Sistemit për Paralajmërim të Hershëm?		<i>Si përdoren të dhënat për të orientuar punën e mëtejme?</i>		
5.	A keni pasur raste të braktisjes që i ka trajtuar ekipi?		<i>Nëse po, sa raste? Cilat ishin shkaqet e braktisjes? Sa është arritur që të kthehen në shkollë?</i>		
6.	A keni pasur raste të mosregjistrimit të fëmijëve që i ka trajtuar ekip, fëmijë të moshës shkollore në zonën e mbulimit të shkollës tuaj?		<i>Nëse po, sa raste? Cilat ishin shkaqet e mosregjistrimit? Sa prej tyre dhe si është arritur të regjistrohen?</i>		
7.	A ka raste fëmijëve/nxënësve që kanë problem me transportin, apo atë e organizon mirë komuna?		<i>Si ndihmohen rastet kur nuk ka transport të rregulluar?</i>		

Lista e pyetjeve sipas indikatorëve relevantë për parandalim dhe reagim ndaj braktisjes					
Shkolla: _____; Komuna: _____				Data: _____	Inspektori _____
Nr.	Pyetje/ kërkesa	Pikat kryesore të theksuara	Nënpyetje	Pikat kryesore të theksuara	Komente
8.	A ka siguri të mjaftueshme për nxënës gjatë vajtje –ardhjes, shkollë-shtëpi?		<i>Po në shkollë a indikacione të dhunës? Nëse po, në çfarë relacionesh?</i>		
9.	A ka rritje të përfshirjes së fëmijëve në klasë parafillore?		<i>Nëse po, sa është rritja dhe si rezultat i kujt (cilave veprime)?</i>		
10.	Si reflektohet gjithëpërfshirja e nxënësve në proceset e mësimi?		<i>Cilat janë praktikat e identifikimit dhe punës së nxënësve me nevoja të veçanta?</i>		
11.	A po e zbatoni protokollin për parandalim dhe referim të dhunës në shkolla		<i>A e përdorni modulën e incidentit dhe manualët didaktike?</i>		
12.	A keni nxënës të panotuar në fund të vitit paraprak?		<i>Nëse po, pse dhe si raportohen ata?</i>		
13.	Tjetër (shëno pyetje)				

Shtojca 6 :

Korniza ligjore, politika arsimore, si dhe referencat tjera që janë përdorur për zhvillimin e modulit

Kuvendi i Republikës së Kosovës. (2019). LIGJI NR. 06/L-084 PËR MBROJTJEN E FËMIJËS. <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=20844>

Kuvendi i Republikës së Kosovës. Ligji për Arsim në Komunitet e Republikës së Kosovës, Ligji Nr.03/L-068. Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / Nr. 30 / 15 qershor 2008, Prishtinë. <https://gzk.rks-gov.net/actdetail.aspx?Actid=2543>

Kuvendi i Republikës së Kosovës. Ligji për arsimin parauniversitar në Republikën e Kosovës, Ligji Nr.04/L-032. Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / Nr. 17 / 16 shtator 2011, Prishtinë. <https://gzk.rks-gov.net/actdocumentdetail.aspx?Actid=2770>

Kuvendi i Republikës së Kosovës. Ligji për Inspektoratin e Arsimit në Republikën e Kosovës, Ligji nr. 06/L-046. Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës / Nr. 13 / 10 Gusht 2018, Prishtinë. <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=17744>

Mehmeti, S., Boshtrakaj, L., Bytyqi, L., Zylfiu, H. & Potera, I., (2018). Përvojat e para në vlerësimin e performancës së shkollës në Kosovë. Instituti Pedagogjik i Kosovës. Prishtinë. <http://ipkMASHT.rks-gov.net/ep-content/uploads/2015/11/Raporti-Pervojat-e-para-ne-vleresimin-e-performances-se-shkolles.pdf>

Mehmeti, S., Zylfiu, H., Potera, I., Buleshkaj, O. dhe Lehner-Stift, U. (2016). Manual për sigurimin e cilësisë në shkollë. Bashkimi Evropian – në kuadër të Projektit të Binjakëzimit për Kosovën.

Ministria e Arsimit dhe Shkencës. (2021). Plani dinamik i punës kundër braktisjes dhe mosregjistrimit të shkollës (2021).

Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë & Instituti Pedagogjik i Kosovës. (2016). *Korniza e sigurimit të cilësisë së performancës së shkollës në Kosovë*. IPK, Prishtinë. <http://ipkmasht.rks-gov.net/kriteret-dhe-treguesit-e-cilesise-se-performances-se-shkolles/>

Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë. (04/2017). *Udhëzimi Administrativ nr. 04/2017: Vlerësimi i performancës në Institucionet e Arsimit*. Prishtinë. <http://masht.rks-gov.net/uploads/2017/08/4-2017-ua-vleresimin-e-performances-se-institucioneve-arsimore-ne-arsimin-parauniversitar-rotated.pdf>

Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë. (2014a). *Mundësi të Barabarta për arsim për të gjithë, Doracak për ekipet shkollë për parandalim dhe reagim ndaj braktisjes dhe mosregjistrimit në arsimin e obliguar*. (MASHT, UNICEF, ECMI)

Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë. (2014b). *Mundësi të Barabarta për arsim për të gjithë, Doracak për ekipet komunale për parandalim dhe reagim ndaj braktisjes dhe mosregjistrimit në arsimin e obliguar*. (MASHT, UNICEF, ECMI)

Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë. (2015). *Strategjia e Sigurimit të Cilësisë për Arsimin Parauniversitar në Kosovë 2016-2020*. Prishtinë. <http://masht.rks-gov.net/uploads/2016/12/qa-strategy-final-shqip.pdf>

Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë. (2015). Udhëzimi administrativ nr. 19/2015, Për sistemimin e nxënësve të cilët kanë migruar nga viti shkollor 2014/2015 <http://masht.rks-gov.net/uploads/2015/12/ua-19-2015>

Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë. (2016). Udhëzimi administrativ nr. 1/2016, Përcaktimi i kushteve, kriterëve dhe procedurave për organizimin e mësimin plotësues për nxënësit e riadhesuar <http://masht.rks-gov.net/uploads/2016/01/ua-masht-nr-01-2016>

Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë. (2016a). Plani Strategjik i Arsimit në Kosovë 2017-2021. Prishtinë. http://masht.rks-gov.net/uploads/2017/02/20161006-psak-2017-2021_1.pdf

Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë. (2016c). *Udhëzimi Administrativ nr. 24/2016: Sigurimi i cilësisë në Arsimin Parauniversitar*. Prishtinë. <http://masht.rks-gov.net/uploads/2016/12/rotatedpdf180.pdf>

Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë. (2018). Udhëzimi administrativ 08/2018 për krijimin dhe fuqizimin e ekipeve për parandalim dhe reagim ndaj braktisjes dhe mosregjistrimit në arsimin parauniversitar <https://masht.rks-gov.net/uploads/2018/06/8-ua-masht-nr-08-2018-per-themelimin-dhe-fuqizimin-e-ekipeve-parandalimdhe-kbmnapu.pdf>

Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë. (2019). Plani i punës kundër braktisjes dhe mosregjistrimit të shkollës (2019 – 2020).

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë. (2017). Raport përmbledhës mbi gjetjet nga monitorimi dhe mentorimi i DKA-ve dhe shkollave, lidhur me funksionimin e EPRBMSH. https://www.childrights-ks.org/site/assets/files/1408/raporti_monitorues_mbi_funksionimin_e_eprbmsht_a5.pdf

Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale. (2010). STRATEGJIA DHE PLANI I VEPRIMIT PËR PARANDALIMIN DHE ELIMINIMIN E PUNËS SË FËMIJËVE NË KOSOVË 2011 – 2016. http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/STRATEGJIA_DHE_PLANI_I_VEPRIMIT_PER_PARANDALIMIN_DHE_ELIMINIMIN_E_PUNES_SE_FEMIJEVE_NE_KOSOVE_2011_-_2016.pdf

Ministria e Punëve të Brendshme (2017). Strategjia për riintegrimin të qëndrueshëm të e personave të riatdhesuar në Kosovë (2018-2022). <https://kryeministri-ks.net/documents/strategjia-shtetore-per-riintegrim-te-qendrueshem-te-personave-te-riatdhesuar-ne-kosove-2018-2022/>

Organizata Ndërkombëtare e Punës (ILO). (2011). HAPAT E ILO-IPEC PËR ELIMINIMIN E FORMAVE MË TË RËNDA TË PUNËS SË FËMIJËVE NË KOSOVË. https://www.ilo.org/wcmsp5/groups/public/---europe/---ro-geneva/---sro-budapest/documents/publication/écms_168280.pdf

Qendra për Arsim e Kosovës /KEC/ (2019). Doracak i Përmbledhjes së Praktikave të mira të Zgjidhjeve Paqësore të Konfliktëve mes Bashkëmoshatarëve në Shkolla.

Qeverisë së Republikës së Kosovës. (2013). Rregullorja QRK- nr. 21/2013 për protokollin për parandalimin dhe referimin e dhunës në institucionet e arsimit para-universitar. <https://masht.rks-gov.net/uploads/2016/06/udhezuesi-final-1.pdf>

Qeverisë së Republikës së Kosovës. (2015). Udhëzuesi për zbatimin e Rregullores së QRK- nr. 21/2013 për protokollin për parandalimin dhe referimin e dhunës në institucionet e arsimit parauniversitar. <http://kec-ks.org/wp-content/uploads/2016/05/Udhezuesi-Final.pdf>

Hyseni, H. (2011). Parandalimi i dhunës në shkolla. Qendra për Arsim e Kosovës – KEC.

Asociacioni i Komunave të Kosovës (2017). Doracak për qeverisjen e arsimit në Komuna. Botimi i tretë. Prishtinë.

Asociacioni i Komunave të Kosovës (2015). Plani Strategjik i AKK-së 2016-2020 (draft). <Http://komunat-ks.net/uploads/2017/01/Strategjia-e-AKK-se-2016-2020.pdf>

Instituti Pedagogjik i Kosovës (2014). *Fëmijët jashtë shkollës – Studim bazë për praktikat e parandalimit dhe të reagimit ndaj braktisjes dhe mosregjistrimit në shkollë*.

Instituti Pedagogjik i Kosovës. (2016d). *Udhëzues për vlerësimin të jashtëm të performancës së shkollës*. IPK, Prishtinë. <http://ipkmasht.rks-gov.net/udhezuesi-per-vleresimin-e-jashtem-te-shkolles/>

“Iniciativa e Kosovës për Integrim KOSINT 2020”. (2019). Raport Tematik në lidhje me arsyet që ndikojnë në braktisjen e shkollimit nga nxënësit e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian. https://kosint2020.net/site/assets/files/1457/arsyet_qe_ndikojne_ne_braktisjen_e_shkollimit nga_nxenesit_e_komuniteteve_rom_ashkali_dhe_egjiptian-1.pdf

